



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE

Nr. Prot.

Tiranë, më 16/02/2024

V E N D I M

PËR SUBJEKTIN E VLERËSIMIT ARJAN MUÇA

Nr. 10, datë 02.02.2024

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

Edona Dushaj	Kryesuese
Enton Radovani	Relator
Kleada Mersinllari	Anëtare

Asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga anëtare e Sekretariatit Teknik, znj. Erlisa Kalaja, në datën 02.02.2024 ora 10:00, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket

SUBJEKTI I VLERËSIMIT: **Arjan Selim Muça**, me funksion aktual Drejtor në Drejtorinë për Hetimin e Narkotikëve në Departamentin e Policisë Kriminale

OBJEKTI: Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit.

BAZA LIGJORE: **Ligji nr. 12/2018**, "Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme", i ndryshuar.

Ligji nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë".

Ligji nr. 49/2012, "Për Organizimin dhe Funksionimin Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative", i ndryshuar.

TRUPA E VLERËSIMIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE,

pasi dëgjoji relatimin e relatorit të çështjes Enton Radovani; dëgjoji subjektin e vlerësimit, **Arjan Muça**, i cili në seancën dëgjimore publike të datës 26.01.2024, kërkoi konfirmimin e tij në detyrën e Drejtor në Drejtorinë kundër Narkotikëve dhe Trafiqeve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi duke u bazuar në tre kriteret e vlerësimit të pasurisë, të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, mbështetur në pikat 1 dhe 2 të nenit 4, të ligjit 12/2018, i ndryshuar,





V Ë R E N

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore është institucioni që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në Ligjin nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.
2. Sipas përcaktimeve të neneve 2, 4 dhe 6 të Ligjit nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, shtetasi z. Arjan Muça është subjekt i vlerësimit kalimtar nga Trupat e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, për shkak të funksionit të tij në datën e zhvillimit të shortit 05.04.2023, si Drejtor i Drejtorisë së Protokollit në Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.
3. Subjekti i vlerësimit, z. **Arjan Muça** iu nënshtrua procedurave të vlerësimit, duke u shortuar në shortin e zhvilluar në datën 05.04.2023, nga Trupat e Vlerësimit në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 7, datë 17.01.2023, “Për procedurat e hedhjes së shortit për trupat e vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit sipas ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
4. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, me vendimin nr. 27/1, datë 18.04.2023, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupës së vlerësimit e përbërë nga: z. Enton Radovani, **Relator**, znj. Edona Dushaj, **Kryesuese**, dhe znj. Kleada Mersinllari **Anëtare**.
5. Trupa e Vlerësimit në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar si edhe në bazë të Rregullores nr.197 datë 23.02.2023, “Për hapat procedural të unifikuar” me Vendimin nr. 27/2, datë 18.04.2023, vendosi fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit z. Arjan Muça.
6. Relatori i çështjes, nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar nr. 27/6 prot., datë 18.04.2023, ka njoftuar subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar, dhe i është



- bërë e njohur përbërja e Trupës së Vlerësimit, duke i kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupës së vlerësimit.
7. Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar deklaratën për konfliktin e interesit në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore në datën 24.04.2023, e cila është protokolluar me nr. 28/10, duke shprehur se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e trupës së vlerësimit.
 8. Relatori i çështjes në vijim ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3 të nenit 25, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.
 9. Në vijim të procesit të mbështetur në nenet 33/1, nenin 42, nenin 46 të ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, relatori i çështjes ka dërguar pranë institucioneve ndihmëse deklaratimet e subjektit të vlerësimit, si më poshtë vijon:
 - a. me shkresën nr. *** prot, datë 19.04.2023, ka dërgua pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit deklaratën e pasurisë dhe dokumentacionin shoqërues;
 - b. me shkresën nr.*** prot, datë 19.04.2023, ka dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit deklaratën e vlerësimit të aftësive profesionale;
 - c. me shkresën nr. *** prot, datë 19.04.2023, ka dërguar pranë Drejtorisë së Analizës dhe Sigurisë së Personelit, në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, deklaratën e kontrollit të figurës.
 10. Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, trupa e vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.
 11. Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve bazuar në nenin 4, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar ka për objekt:
 - ✚ vlerësimin e pasurisë;
 - ✚ kontrollin e figurës;
 - ✚ vlerësimin e aftësive profesionale.
 12. Trupa e vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në:
 - a. Ligji nr.12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat” i ndryshuar.
 - b. Ligji nr.128/2021, “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”
 - c. Ligji nr.40/2015, “Kodi i Procedurës Administrative”
 - d. Ligji nr.49/2012 “Për gjykatën Administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative”
 - e. Ligji nr.9367 datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”
 - f. Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 7 datë 17.01.2023, “Për procedurat e hedhjes së shortit”

g. Rregulloren nr.197 datë 23.02.2023, “Për hapat procedural të unifikuar” duke verifikuar dhe vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme dhe konkretisht deklaratat e dorëzuara nga vetë subjekti i vlerësimit në Ministrinë e Brendshme që janë:

-  *Deklarata e Pasurisë,*
-  *Deklarata për Kontrollin e Figurës,*
-  *Formulari i Vlerësimit Profesional*
-  *Dokumentacion bashkëlidhur deklaratave për të justifikuar deklaratimet,*

- h. Raportet përmbledhëse të ILDKPKI-së, Drejtorisë së Analizës dhe Sigurisë së Personelit në AMP, dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
- i. Provat shkresore/dokumente të administruara nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar.
- j. Provat dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit.
- k. Ka marrë në konsideratë bashkëpunimin, gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit.

13. Trupa e vlerësimit, me datë 15.12.2023, pasi dëgjoi relatorin, dhe pasi krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, kishin nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatoi se janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit z. Arjan Muça, me Vendimin nr. 2, datë 15.12.2023, vendosi;

- a. Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit z. **Arjan Muça;**
- b. Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:
 -  *Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht;*
 -  *Rezultatet e hetimit të pasqyruara në relacionin paraprak për të tre komponentët, e vlerësimit pasuror, kontrollit të figurës dhe atij profesional;*
- c. Të ftojë subjektin për t’u njohur me dosjen dhe me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 50, të ligjit nr.12/2018, nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurës Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme prej 5 ditësh për t’u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegime.

14. Hetimi administrativ përfshiu edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 3, pika 11, neni 5 i Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, si dhe nenit 3, pika 12 dhe 14, e Ligjit nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.

15. Në datën 18.12.2023, trupa e vlerësimit, njoftoi subjektin e vlerësimit për zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 02.02.2024 ora 10:00, në ambiente e sallës së mbledhjes së Ministrisë së Brendshme, në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar

II. SEANCA DËGJIMORE

Seanca dëgjimore për subjektin e vlerësimit z. Arjan Muça, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar si dhe Kodin e Procedurave Administrative. Subjekti i vlerësimit kishte zgjedhur të mos përfaqësohej me mbrojtës ligjor në këtë seancë. Në fund të seancës dëgjimore të datës 26.01.2023, subjekti i vlerësimit z. Arjan Muça kërkoi konfirmimin në detyrë. Në datën 26.01.2024, trupa e vlerësimit shpalli vendimin.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT

Me subjektin e vlerësimit është komunikuar me anë të postës elektronike, duke i bërë pyetje dhe kërkuar sqarime, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave. Subjekti i vlerësimit z. Arjan Muça, ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të vlerësimit, në përputhje me pikën 2, të nenit 48, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar. Subjekti i vlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë hetimit.

IV. VLERËSIMI I PASURISË

16. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e vlerësimit, në përputhje me kreun III, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, dhe veçanërisht në nenin 31 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e vlerësimit kalimtar dhe për personat e lidhur me të.
17. Në zbatim të nenit 32, pika 2, të ligjit nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit z. **Arjan Selim Muça**, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në datën 08.03.2023, brenda afateve ligjore. Formulari i pasurisë ka nr. 4 index, viti 2023.
18. Procedurat e deklarinimit të pasurisë kryhen sipas përcaktimeve të nenit 32 dhe 33, ndërsa vlerësimi i pasurisë nga trupa e vlerësimit kryhet sipas përcaktimeve të nenit 34, të ligjit 12/2018, i ndryshuar.
19. Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruar dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruar, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, janë kryer verifikime në të gjitha institucionet apo personat juridikë, publikë apo privatë.
20. Gjithashtu, trupa e vlerësimit ka mbajtur në konsideratë deklarinimet e dhëna nga subjekti për vërtetimet e të ardhurave për secilin vit kalendarik, të shoqëruara me dokumentacion zyrtar; raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së në zbatim të neneve 33/1 dhe 34; shpjegimet e subjektit për burimin e të ardhurave; mbulimin e shpenzimeve dhe të detyrimeve financiare. Ka kontrolluar dhe krahasuar gjendjen pasurore dhe ndryshimet e saj në vite,

burimin e krijimit, pagimin e detyrimeve financiare, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e vlerësimit dhe personave të lidhur me të.

21. Trupa e vlerësimit për realizimin e procesit të vlerësimit të pasurisë administroi:

- ✚ deklaratën e pasurisë dhe dokumentacionin bashkëlidhur;
- ✚ raportin e hollësishëm të përgatitur nga ILDKPKI;
- ✚ provat shkresore/dokumente të vena në dispozicion nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me ligjin nr.12/2018, i ndryshuar;
- ✚ dokumentacionin e paraqitur në deklaratimet e subjektit, si dhe përgjigjet e pyetjeve të dërguara nëpërmjet postës elektronike.

22. Hetimi administrativ konsistoi në:

- ✓ verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve, në lidhje me gjendjen pasurore të deklaruar nga subjekti i vlerësimit;
- ✓ verifikimin e burimit/eve të krijimit të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruara si edhe në mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet financiare të ligjshme;
- ✓ evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi apo në përdorim;
- ✓ evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme si edhe evidentimit të rasteve të konfliktit të interesit.

23. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja;

ILDKPKI-ja, në përputhje me Ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik”, i ndryshuar, Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, në Ligjin nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave”, i ndryshuar, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative, ka dërguar një raport¹, të hollësishëm dhe të arsyetuar, bazuar në dokumentacionin e administruar, për subjektin e vlerësimit z. Arjan Muça, ku është konstatuar se:

- ✓ deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare;
- ✓ nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- ✓ nuk është kryer fshehje e pasurisë;
- ✓ nuk është kryer deklarim i rremë;
- ✓ subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.

A. PROCEDURA E VLERËSIMIT/HETIMIT E KRYER NGA TRUPA E VLERËSIMIT

¹ Raporti nr. 6/57, datë 03.10.2023, i ILDKPKI-së.

24. Bazuar në nenin 34, të ligjit nr.12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave”, i ndryshuar, Trupa e Vlerësimit hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e vlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI, (b) raportin/vlerësimin e kryer nga ILDKPKI; (c) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private sipas nenit 34 të ligjit 12/2018; (ç) deklaratimet e subjektit të vlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (d) shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit; (dh) deklaratimet në seancë dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.
25. Trupa e Vlerësimit hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 12/2018, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur, (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllimin evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo ndonjë konflikti të interesit.

V. DEKLARIMI I PASURIVE

Subjekti i vlerësimit ka deklaruar në deklaratën e pasurisë në zbatim të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, si vijon:

Pasuria nr. 1.

✚ Apartament banimi, me sipërfaqe 61.8 m², Nj.9, Rr. "****", Hyrja **, apartamenti **, Tiranë, blerë në vitin 2003. Vlera: 30.000 USD.

Burimi i krijimit: a) 20.000 Usd, kredi nga NBG Bank, viti 2003. b) 10.000 Usd, kursime nga paga e subjektit dhe e bashkëshortes deri në vitin 2003. **Pjesa takuese** 50%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Certificate për vërtetim pronësie, nr. ***, dt.25.3.2014, e llojit apartament me sipërfaqe 61.8 m², në emër të Arjan Muça dhe Laurela Muça, në adresën Rr. "****", Hyrja **, Apartament **, nr. pasurie ***, vol.**, fq. **, ZK**, Tiranë.
- Kartela e pasurisë së paluajtshme, në emër të Arjan Muça dhe Laurela Muça, apartamentit me sipërfaqe 61.8 m², nr. pasurie ***, vol. **, fq. **, Tiranë.
- Kontratë personale kredie me interesa të ndryshueshme 20.000 Usd, me Bankën Kombëtare të Greqisë, datë 20.03.2003, me kredi-marrës Laureta Shytaj dhe dorëzanës Arjan Muça, P.Sh. dhe J.Sh., të shumës 20.000 Usd, me qëllim blerjen e apartamentit në Rr. "****", godina ** kate, seksioni **, e ndërtuar nga kompania "Ferar" ShPK. Sigurimi i kredisë vendoset mbi pasurinë e paluajtshme, apartament në rrugën "****", Pallati **, shk.** k.**, ap.**, pasuria me numër ***, vol. **, fq.**, ZK **, Tiranë.

- Deklaratë noteriale nr. ***, date 9.4.2010, nga Banka NBG, e cila deklaroi se ka lidhur kontratë kredie nr. ***, datë 20.3.2003, dhe ka bërë bllokimin e pasurisë nr. ***, vol. **, faqe **, të ndodhur në ZK **, Tiranë, në pronësi të P. Sh., L. Sh. dhe J.Sh, me anë të kësaj deklarate kërkon çregjistrimin e bllokimit të bërë mbi këtë pasuri.

Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

- ✚ **ABI Bank**, me shkresën nr. **prot., datë 8.05.2023, konfirmon se Laurela Muça, ka pasur kredi bankare hipotekore, më datë 26.03.2003, në shumën 20.000 Usd, me afat maturimi 08.04.2010. Kredia rezultoi e mbyllur. Bashkëlidhur nxjerrje llogari bankare, ku në datë 26.03.2003, është disbursuar kredia bankare, në vlerën 20.000 Usd. Në datën 27.03.2003, është tërhequr cash vlera 19.613 Usd. Kredia rezultoi e mbyllur në datën 08.04.2010, pasi është depozituar vlera 13.900 Usd nga Arjan Muça dhe debituar vlera 13.446 Usd pagesë principali.
- ✚ **Drejtoria Vendore e ASHK**, Tirana Rurale **, Tirana Rurale **, Tirana Jug, Tirana Veri, Zonat e Stimuluara, në përgjigjet e tyre nr. ** prot., nuk konfirmojnë pasuri të regjistruar në emër të subjektit dhe personave të lidhur me të. Në proces verbalin e datës 16.6.2023, subjekti u pyet në lidhje me vlerën e apartamentit, dhe konstatimin e ABI Bank.
- ✚ **Në procesverbalin e datës 22.6.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit subjekti sqaroi se *“në kontratën e porosisë, është porositur një banesë me sipërfaqe 68 m², me çmim 500 Usd/m², me një shumë totale prej 34.000 Usd. Nga verifikimet e bëra në banesë, rezultoi se banesa kishte një sipërfaqe prej 61.8 m², pra një diferencë çmimi prej 3.100 Usd. Gjithashtu, vlerës së përgjithshme të banesës i janë zbritur dhe dyert e brendshme dhe pajisjet hidrosanitare, që nuk janë marrë nga firma ndërtuese. Në këto kushte, nga shuma totale prej 34.000 Usd janë zbritur 4.520 Usd. Sipërfaqja prej 61.8 m², reflektohet edhe në kontratën e shitblerjes dhe certifikatën e pronësisë, por ndryshimi i çmimit nuk është reflektuar nga administrata e firmës ndërtuese në kontratën e shitblerjes”*.
- Lidhur me burimin financiar për këstet e paguara, deklaroi se *“kësti i parë prej 10.000 Usd është paguar nga kursimet e krijuara ndër vite nga paga e tij dhe e bashkëshortes, ndërsa kësti i dytë është paguar nga shuma e marrë si kredi. Për shlyerjen e shumës së mbetur të kredisë, prej 13.900 Usd janë përdorur 11.000 Euro nga kursimet që ka pasur gjendje cash, të krijuara nga paga e tij dhe e bashkëshortes, të pasqyruara edhe në deklaratimet e pasurisë së asaj periudhe”*.

Krahas shpjegimeve të sipërpërmendura subjekti paraqiti dokumentacionin justifikues, si më poshtë vijon:

- Kontratë porosie nr. ***, datë 27.1.2003, me palë sipërmarrëse "Ferar" ShPK, dhe palë porositëse Laurela Muça, të apartamentit me sipërfaqe 68 m², që do të ndërtohej në godinën 10 kate në Rr. "****" Tiranë, në shumën 34.000 Usd. Paga do të bëhet: kësti i parë në vlerën 14.000 Usd do të paguhet në datën 01.02.2003. Kësti i dytë prej 20.000 Usd do të paguhet nëpërmjet kredisë bankare pranë bankës NBG.

- Mandat arkëtimi nr.***, datë 30.1.2003, nga Laurela Muça, 10.000 Usd me përshkrimin "blerje apartamenti kësti i parë".
 - Mandat arkëtimi nr.***, datë 15.04.2003, arkëtuar shuma 19.480 Usd, nga Laurela Muça, me përfitues shoqëria "Ferari ShPK", me përshkrimin "Likuidim i kështit të dytë të ap. 1+1, 67 m², në katin e dytë".
 - Mandat arkëtimi, datë 18.04.2010, pranë NGB Bank, të shumës 13.900 Usd, nga Arjan Muça.
 - Kontratë shitje apartamenti, nr. ***, datë 30.10.2013, me palë shitëse "Ferari" ShPK dhe palë blerëse Arjan Muça dhe Laurela Muça, të apartamentit me sipërfaqe 61.8 m², regjistruar me nr. pasurie ***, vol. **, fq.***, në Rr. "****" Tiranë, në shumën 34.000 Usd. Çmimi i shitjes së apartamentit është likuiduar në periudhat e mëparshme. Certificate për vërtetim pronësie nr.***, datë 25.3.2014, të apartamentit me sipërfaqe 61.8 m², regjistruar në emër të Arjan dhe Laurela Muça. Kartelë e pasurisë së paluajtshme. Kartat e Id-së.
- ✚ **Në proces-verbalin e datës 21.09.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit subjekti sqaroi se *“ka kryer punimet e papërfunduara nga firma e ndërtimit, konkretisht dyert e brendshme dhe hidrosanitare, me vlerë rreth 25.000 lekë. Periudhën kur e ka marrë në dorëzim apartamentin nuk e kujton, por referuar kontratës së sipërmarrjes ka hyrë në mesin e vitit 2003. Punimet janë kryer gjatë gjysmës së dytë të vitit 2003. Në kontratë nuk janë të reflektuara punimet e kryera prej subjektit. Në lidhje me mobilimin, në fillim kam jetuar në shtëpinë e babait, dhe mobiljet e asaj shtëpie janë transferuar në shtëpinë e re, të cilat i kam blerë para martesë, me një vlerë të përafërt, rreth 82.000 lekë, por nuk disponoj dokumentacion për shkak të kohës së largët. Burimi në lidhje me këto shpenzime janë nga të ardhurat familjare të miat dhe të bashkëshortes, ndër vite”*.

Konkluzion:

- ✓ Trupa e vlerësimit konstaton se apartamenti me sipërfaqe 61.8 m² në Rr. "****", Tiranë, është përfituar me kontratë porosie në vitin 2003, me burim të ardhurat familjare dhe kredi bankare, e fundit e shlyer në vitin 2010.
- ✓ Subjekti ka sqaruar vlerën e apartamentit të paguar prej tij prej 30.000 Usd, pavarësisht çmimit të përcaktuar në kontratë. Ka paraqitur mandat pagesat e vitit 2003, në favor të shoqërisë "Ferari" ShPK. Apartamenti me sipërfaqe 61.8 m² në Rr. "****", Tiranë, është porositur dhe likuiduar brenda vitit 2003, kurse kontrata përfundimtare e shitblerjes nuk ka ndryshuar, por ka vazhduar të paraqitej me vlerë 34.000 Usd dhe nuk ka reflektuar sipërfaqen faktike të apartamentit.

Pasuria nr. 2.

- ✚ Apartament banimi, me sipërfaqe 115 m², Njësia **, Rr. "****", shkalla nr.**, apartamenti **, Tiranë blerë në vitin 2011. Vlera: 54.625 euro. Pjesa takuese: 100%.

Burimi i krijimit: a) 50.000 euro marrë hua nga një person fizik b) 4.625 euro, kursime nga paga e subjektit dhe e bashkëshortes.

- Subjekti deklaron se nga një person fizik ka kryer huamarrjen për blerje apartamenti banimi, në vitin 2011. Shuma e huamarrjes ka qenë 50.000 euro, të cilën e kam shlyer me këste, deri në dhjetor të vitit 2021, është shlyer e gjithë shuma. Detyrimi i mbetur 0 euro.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Certificate për vërtetim pronësie, nr. ***, dt.5.4.2011, e llojit apartament me sipërfaqe 115 m², në emër të Arjan Muça, në adresën Rr. “***”, pasuri me nr. ***, vol.**, fq.**, ZK ***, Tiranë. Kartela e pasurisë në emër të Arjan Muça, për apartament me sipërfaqe 115 m², pasuri me nr. ***, vol.27, fq.**, ZK ***, Tiranë.
- Deklaratë noteriale nr. ***, date 25.11.2019, me deklarues P.Sh., e cila deklaron se në vitin 2011, i ka dhënë hua shumën 50.000 euro, pa interes dhe pa afat, vajzës së saj Laurela Muça dhe bashkëshortit Arjan Muça, për blerjen e apartamentit në adresën Rr. “***”, sh.**, ap. **, Tiranë. Nga kjo shumë është kthyer pjesë-pjesë, vlera prej 20.000 euro. P.Sh. sqaron se, për shkak të marrëdhënieve të posaçme familjare dhe në kushtet e lejuara nga legjislacioni në fuqi, nuk ka nënshkruar ndonjë marrëveshje me vajzën e saj Laurela Muça.
- Deklaratë noteriale nr.**, datë 4.1.2022, me deklaruese P.Sh., e cila deklaron se shuma 50.000 euro, dhëne hua vajzës së saj Laurela Muça dhe bashkëshortit Arjan Muça për blerjen e apartamentit sipas deklaratës nr. ***, datë 25.11.2019, i është kthyer pjesë - pjesë, në periudha të ndryshme, respektivisht, në dhjetor 2018 vlera 10.000 euro, në dhjetor 2019 vlera 10.000 euro, deri në dhjetor 2020, shuma 15.000 euro dhe deri në dhjetor 2021 shuma 15.000 euro. Deklaruesja shton se Laurela Muça dhe Arjan Muça, nuk kanë detyrime të tjera ndaj deklarueses. Kopje Id-së.

Hetimi i trupës së vlerësimit.

- ✚ **Drejtoria Vendore e ASHK**, Tirana Rurale 1, Tirana Rurale 2, Tirana Jug, Tirana Veri, Zonat e Stimuluara, në përgjigjet e tyre, nuk konfirmojnë pasuri të regjistruar në emër të subjektit dhe personave të lidhur me të.
- ✚ **QKB**, me shkresën nr.** prot., datë 19.6.2023, konfirmon se shtetasi L.Sh., nuk figuron të jetë pajisur me NUIS (NIPT), si person fizik apo të zotërojë kuota/aksione në shoqëri tregtare të regjistruara pranë regjistrimit tregtar.
- ✚ **DPI**, me shkresën nr. ** prot., datë 26.6.2023, konfirmon se shtetasi L.Sh., nuk figuron i regjistruar në organet tatimore, për ushtrim të ndonjë aktiviteti privat.
- ✚ **ISSH**, me shkresën nr. ** prot., datë 3.7.2023, përcjell shkresën me nr.** dt. 27.6.2023, të Degës së Arkivit të Rajonit Tiranë, e cila informon se nga mënyra e administrimit dhe përpunimit të listë pagesave, për periudhën 1994 - 2012, të punonjësve të siguruar në subjektet shtetërore, juridike apo fizike, nuk mund të konfirmohet periudhë kontributesh apo paga mbi të cilën janë siguruar, në qoftë se nuk jepet emërtimi i qendrës së punës, NIPT-i i subjektit, fotokopje e librezës së punës për shtetasin e kërkuar.
- ✚ **Në proces-verbalin e datës 16.6.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti u pyet në lidhje me burimin financiar të huasë, në vlerën 50.000 euro.

✚ **Me postën elektronike të datës 22.6.2023**, drejtuar ILDKPKI-së dhe verifikuar nga trupa e vlerësimi, subjekti sqaroi se *“shuma prej 50.000 Euro, është krijuar nga kursimet e familjes së bashkëshortes së tij dhe konkretisht, të punës të vjehrrës P. Sh., si mjeke, të punës së kunatës, J.Sh., si punonjëse në projekte të ndryshme dhe në administratën shtetërore, të punës të bashkëshortes së tij deri para martesë, si punonjëse në organizata ndërkombëtare. Gjithashtu, familja e bashkëshortes, ka patur para të trashëguara edhe nga puna e kryefamiljarit të tyre të ndjerë, i cili ka punuar si avokat deri në vitin 1996. Subjekti disponon vetëm kontratën e shitblerjes së apartamentit dhe nuk disponon kontratë porosie dhe as fatura te pagesës së kësteve. Huanë e ka marrë në vitin 2011, për blerjen e apartamentit. Për shkak të marrëdhënieve familjare të posaçme dhe në kushtet e lejuara nga legjislacioni në fuqi, nuk kanë nënshkruar ndonjë marrëveshje. Pas miratimit të ligjit për vlerësimin kalimtar të punonjësve të policisë së shtetit, meqenëse ishte subjekt i këtij ligji, ka përpiluar deklaratën noteriale me qëllim formalizmin e huamarrjes. Pagesat për shlyerjen e huasë janë bërë të gjitha në cash”*.

Bashkëlidhur:

- **Vërtetim për vjetërsinë për efekt pensioni** që konfirmon se L.Sh. ka filluar marrëdhënie pune nga data 22.08.1959, pranë Ndërmarrjes të Ndërtimit "P. Rexhepi", Kantieri Regj. i Vjetër, Vlorë.
- **Kontratë shitje** datë 24.3.2011, me palë shitëse "Xhajs Tirana" ShPK, dhe palë blerëse Arjan Muça, të apartamentit me sipërfaqe 115 m² dhe ambiente të përbashkëta 16 m², në adresën Rr. "****", ZK ****, e regjistruar me nr. pasurie ****, vol. **, fq. **, Tiranë, në vlerën 54.625 euro, e shlyer totalisht jashtë zyrës noteriale, gradualisht nëpërmjet bankës, para nënshkrimit të kontratës.
- **Vërtetim** për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare për P.Sh., për periudhën 1994 - mars 2011, në vlerën rreth 4.186.377 lekë. Pasqyrë përmbledhëse + kopje ID-së.
- **Vërtetim** për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare nr. **** prot., datë 03.12.2019, për J.Sh., e cila ka derdhur kontribut shoqëror për periudhën dhjetor 2005 - mars 2011. Pagat në shumën bruto për këtë periudhë janë rreth 4.164.717 lekë. (sigurimi i pagës ka vlera me të vogla). Pasqyrë përmbledhëse.
- **Vërtetim** për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare nr. **** prot., datë 04.12.2019, për Laurela Shytaj (Muça), me pagë bruto, për periudhën prill 2001- korrik 2002.
- **Deklaratë** e shtetasit L.G., datë 12.10.1994, ku deklaron se nëpërmjet prokurës së posaçme nr. ****, kërkon të përfaqësohet nga avokati Lirim Shyti, nga data 07.10.1994. Autorizim prokurimi datë 13.10.1995, nga shoqëria Teknotrade LTD ku presidenti i firmës L.G., autorizon juristin e firmës L.Sh. ta përfaqësojë në të gjitha shkallët e sistemit gjyqësor. Shkresë nr. ****., datë 13.10.1994, për zhbllokim të veprimtarisë së firmës Teknotrade.
- **Deklaratë** datë 29.7.1995, nga shoqëria Teknotrade LTD, ku presidenti i firmës L. G., deklaron për marrëdhënie financiare me avokat L.Sh.. (dokument në gjuhë italiane). Kthim përgjigje nr.****, datë 12.01.2022, nga DRT Tiranë, me anë të së cilës informon se nuk disponohet informacion në lidhje me të ardhurat e biznesit privat të z. L.Sh., për periudhën 1991 - 1996, për shkak të kohës së largët.

- **Shkresë nr. *** rep., datë 4.5.1992**, nga Gjykata e Rrethit Tiranë, drejtuar Drejtorisë së Postë Telekomit Tiranë, ku njofton se numri i telefonit ***-** i kësaj gjykate, do të lidhet si numër privat në emër të avokat L. Sh.
- ✚ **Në proces-verbalin e datës 21.9.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti në lidhje me kontratën e nënshkruar midis palëve, nr. ***, datë 24.3.2011, subjekti sqaroi se *“ka qenë një gabim i noterit në lidhje me frazën "është shlyer totalisht nëpërmjet bankës gradualisht". Sqaroi se ka qenë një gabim nga ndonjë kontratë e mëparshme tip e noterit. Në lidhje me mobilimin e kësaj shtëpie, ka transferuar një pjesë të rëndësishme të mobilieve të apartamentit të banimit me sipërfaqe 61.8 m², Rr. "****", ka investuar në kuzhinën e gatimit vlerën rreth 200.000 lekë dhe ka bërë dhomën e djemve, ku ka shpenzuar vlerën 15.000 lekë për krevat për secilin dhe një tavolinë në shumën rreth 10.000 lekë për secilin. Këto shpenzime janë bërë pjesë-pjesë sipas mundësive gjatë vitit 2012 e në vazhdim, pasi nuk i kujtohet koha ekzakte. Burimi janë të ardhurat nga pagat e subjektit dhe të bashkëshortes. Për shkak të kohës së largët nuk disponon fatura për mobilimin”. Gjithashtu sqaroi se: “...në lidhje me shpenzimet/investimet nga ana e familjarëve të bashkëshortes, (nëna, motra dhe i ndjeri vjehërri), ata nuk kanë kryer investime të tjera deri në vitin 2011”.*

Konstatim:

- ✓ Trupa e vlerësimit, në zbatim të ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, konstaton se bazuar në deklarimin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, shpjegimet në procesverbal, si dhe në korrespondencën e administruar nga institucionet ligjzbatuese, në mënyrë të përmbledhur rezulton se:
 - Apartamenti me sipërfaqe 115 m², në Rr. "****", Tiranë është blerë në vlerën 54.625 Euro, në vitin 2011, me burim huamarrje në vlerën 50.000 Euro dhe pjesa tjetër kursime familjare.
 - Huamarrja është formalizuar me deklarata noteriale të viteve 2019 dhe 2022, pasi palë huadhënësve ka qenë nëna e bashkëshortes, me burim të ardhura familjare nga paga e saj, e vajzës dhe bashkëshortit.
 - **Babai i bashkëshortes, i cili ka ndërruar jetë, ka punuar avokat deri në vitin 1996 dhe ka realizuar të ardhura, për te cilat mungon dokumentacioni dhe nuk mund të vërtetohet për shkak të një kohe të largët (përafërsisht 26 vjetësh).**
 - Subjekti ka deklaruar shlyerjen totale të huasë, me burim të ardhurat familjare të tij.

Konkluzion:

- ✓ Trupa e vlerësimit konstaton se konfirmohet burimi i krijimit të kësaj pasurie me të ardhurat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit.

Pasuria nr. 3.

Shtëpi druri me sipërfaqe 80 m², fshati ***, Komuna ***, Librazhd ndërtuar në vitet 2013 - 2015. Vlera: 3.000.000 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Burimi i krijimit: a) 1.500.000 lekë, kursime nga paga e babait, z. S.M., në KMSH. b) 1.500.0000 lekë, kursime nga paga e subjektit dhe e bashkëshortes.

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Certifikate për vërtetim pronësie nga ASHK**, datë 17.02.2021, në emër të Arjan Muça, të ndërtesës me sipërfaqe 80 m², në ZK***, me numër pasurie ***, në adresën, Librazhd, ***.
- **Kartela e pasurisë së paluajtshme** për ndërtesë me sipërfaqe 80 m², nr. ZK***, me numër pasurie ***, në adresën, Librazhd, ***, në emër të Arjan Muça. Fragment i hartës kadastrale.
- **Preventiv, nga Alb Eraldo ShPK**, Për shtëpinë me sipërfaqe 80 m², në emër të Arjan Muça, ku totali i punimeve shkon në vlerën rreth 22.200 euro.
- **Kontratë shërbimi** datë 15.07.2013, midis shoqërisë ndërtuese Alb Eraldo ShPK. dhe Arjan Muça, për ndërtimin e një shtëpie druri me sipërfaqe 80 m², me dy veranda 5.1 m² dhe një katërkëndëshe me sipërfaqe 9 m², në vlerën 22.200 euro (sipas kursit të këmbimit, euro x 135 lekë = 2.997.000 lekë). Janë paguar 10.000 euro (1.350.000 lekë). Detyrimi i shtetasit Arjan Muça është në vlerën 12.200 euro (1.647.000 lekë) dhe do të paguhet në momentin e përfundimit të objektit.
- **Vërtetim** nr. *** prot., datë 25.9.2018, nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, që vërteton se S.M. , ka përfituar të ardhura nga viti 1999 - shtator 2016, në shumën rreth 10.950 Usd dhe 13.440.000 lekë.
- **Deklaratë** për përfshirjen në procesin e legalizimit të shtetasit Arjan Muça, datë 29.01.2015, për ndërtimin e vitit 2013. Certifikatë familjare në emër të S. M.
- **Leje legalizimi** nr. ***, datë 20.10.2020, nga Drejtoria Rajonale e Aluiznit Elbasan, në emër të Arjan Muça, të godinës 1 kat, me sipërfaqe 80 m² në ZK ***, nr. pasurie ***, me parcelë ndërtimore me sipërfaqe 240 m². Planimetria e katit përdhe me sipërfaqe 80 m², ndërtim + 10.2 m² verandë.
- Shkresë nr. *** prot., datë 7.01.2020, nga Bashkia Librazhd, drejtuar shtetasit Arjan Muça, për pagesën e taksës të ndikimit në infrastrukturë, për ndërtesën 1 kat banimi me sipërfaqe 90 m², në vlerën 14.609 lekë. Mandat arkëtimi nga Arjan Muça, të shumës 14.609 lekë.

Hetimi i trupës së vlerësimit.

- ✓ **ASHK**, me shkresën nr. ***, datë 12.06.2023, konfirmon se shtetasi Arjan Selim Muça rezulton vetë deklarues, nr. prot. ***, datë 29.01.2015, Regjistri i Deklaratave Stebevë, Elbasan.
- ✓ **ASHK, Drejtoria Vendore Elbasan**, me shkresën nr. *** prot., datë 30.06.2023, konfirmon se Arjan Selim Muça figuron aplikues me formularin e vetë deklaramit nr. ***,

datë 29.01.2015, “Për objektin informal, të ndodhur në Steblevë, për të cilin është pajisur me Leje Legalizimi nr. ***, datë 20.10.2020”.

Në proces-verbalin e datës 16.6.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti u pyet në lidhje me burimin financiar dhe regjistrimin e pronës, mbi truallin e të cilës është ndërtuar pasuria.

Me postën elektronike të datës 22.6.2023, drejtuar ILDKPKI-së dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti sqaroi se *“nuk disponon fatura të pagesave, por disponon preventivin dhe kontratën e shërbimit. Shuma prej 1.500.000 lekë i është dhënë nga babai i tij dorazi dhe pa dokumente. Kjo shumë ka qenë kontribut i tij për ndërtimin e shtëpisë në fshatin e tij. Burimi i të ardhurave ka qenë paga e tij si kryetar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë. Për regjistrimin e kësaj prone, në vitin 2015, subjekti ka bërë deklaratë për përfshirje në procedurat e legalizimit. Në vitin 2020, ka dalë leja e legalizimit”*.

Gjithashtu sqaroi se *“...në vitin 2021 i ka paguar Bashkisë Librazhd, taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe pas këtij veprimi është bërë regjistrimi i pronësisë së shtëpisë. De fakto, toka në të cilën ishte bërë ndërtimi, është e familjes së babait të tim të ndjerë, por duke qenë se në kohën kur është bërë regjistrimi i tokave në fshat është synuar vetëm regjistrimi i tokës bujqësore, kjo tokë ka mbetur pa u regjistruar dhe ka kaluar pronë shtet”*.

Në proces-verbalin e datës 21.09.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti sqaroi *“në lidhje me mobilimin e shtëpisë së drurit, se ka kryer shpenzime për dy dhoma gjumi të tij dhe të fëmijëve, pas vitit 2017, e në vazhdim, ku vlera totale është rreth 200.000 lekë. Gjithashtu ka kryer shpenzime për kuzhinën dhe pajisjet e saj, në vlerën 200.000 lekë në vitin 2019, me burim të ardhurat nga pagat. Fatura në lidhje me shpenzimet e mësipërme nuk ka”*.

- Subjekti ka deklaruar shpenzime mobilimi në vlerën rreth 400.000 lekë, gjatë periudhës 2017 - 2019.

Konkluzion:

Bazuar në deklarinimin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga institucionet ligjzbatuese dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, në mënyrë të përmbledhur rezultoi se:

- Shtëpia prej druri, me sipërfaqe 80 m², në fshatin ***, Komuna ***, Librazhd, është ndërtuar në periudhën 2013 - 2015, me vlerë sipas preventivit, 22.200 Euro, me burim kursime familjare 1.500.000 lekët nga të ardhurat e babait i punësuar pranë Komunitetit Musliman Shqiptarë. Punimet janë kryer nga shoqëria “Alb Eraldo ShPK”. Vetëdeklarimi për legalizim është i vitit 2015, legalizimi është kryer në vitin 2020 dhe regjistrimi në hipotekë në vitin 2021.

- ✓ **Trupa e vlerësimit konstaton se konfirmohet burimi i krijimit të kësaj pasurie me të ardhurat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit.**

Pasuria nr. 4.

- ✚ Automjet ne pronësi, tip Land Rover, viti prodhimit 2000, blerë në vitin 2013. Vlera: 1.500 euro. Pjesa takuese: 100%.

Burimi i krijimit: Nga kursimet e të ardhurave familjare 2012-2013.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Çertifikatë e pronësisë së mjetit me targa AA***X, i llojit Land Rover, në emër të Arjan Muça.

Bashkëlidhur: Dosje e mjetit: Deklaratë doganore datë. 07.11.2013. Faturë shitje në gjuhën gjermane. Faturë shitje datë 07.11.2013, midis I.D. dhe Ajran Muça të mjetit Land Rover, vit prodhimi 2000, me targa *** në shumën 1.500 euro.

Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit.

- **Verifikimi i kryer pranë DPSHTRR**, me shkresën nr. *** prot, datë 11.5.2023, konfirmon në pronësi të Arjan Muça, mjetin me targa AA***X. Bashkëlidhur: Dosje e mjetit: Deklaratë doganore datë. 07.11.2013. Faturë shitje në gjuhën gjermane. Faturë shitje datë 07.11.2013, midis I.D. dhe Ajran Muça të mjetit Land Rover, vit prodhimi 2000, me targa *** në shumën 1.500 euro.
- Llogari bankare për pagat në **Raiffeisen Bank**, me balancë deri në datë 31.12.2022, në shumën 49.821 lekë. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: Të ardhurat nga paga në Policinë e Shtetit.
- **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. *** prot., datë 08.05.2023, konfirmon se Arjan Muça ka llogari page, me balancë në datën 06.03.2023, në vlerën 110.923 lekë.

Konkluzion:

- ✓ **Trupa e vlerësimit konstaton se konfirmohet burimi i krijimit të kësaj pasurie me të ardhurat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit.**

Pasuria nr. 5.

- Gjendje Cash. Vlera: 600.000 lekë. Pjesa takuese: 50%.
Burimi i krijimit: Kursime gjatë viteve.
- Llogari bankare (kursimi) në Bankën Kombëtare Tregtare. Vlera 10.000 euro.
Burimi i krijimit: Të ardhura nga paga e bashkëshortes, gjatë vitit 2022.

Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

BKT me shkresën nr. * prot., datë 09.05.2023**, nuk konfirmon llogari në monedhën euro në emër të Arjan Muça. BKT, me **postën elektronike të datës 12.06.2023**, ka bashkëlidhur nxjerrje llogarie bankare në monedhën euro, në emër të Arjan Muça, ku në datën 25.01.2023, është depozituar vlera prej 10.000 euro. Gjendja në datë 06.03.2023, është në vlerën 10.000 euro.

Në proces-verbalin e datës **16.06.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti u pyet në lidhje me burimin e krijimit të shumës së deklaruar. Me postën elektronike të datës **22.06.2023**, drejtuar ILDKPKI-së dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti sqaroi se *“burim janë të ardhurat të kursyera gjatë vitit 2022, nga paga e bashkëshortes në Këshillin e Evropës”*.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Buletini i pagesave mujore të Laurela (Shytaj Muça), nga Këshilli i Evropës, për vitin 2022, shuma rreth 23.050 euro. (dokument në gjuhën frënge).
- Konfirmim i llogarisë bankare, datë 20.3.2023, nga BKT, në emër të Arjan Muça.

Në **proces-verbalin e datës 21.9.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti sqaroi se *“ai dhe bashkëshortja kanë kursyer për vitin 2022, vlerën prej 10.000 euro, nga pagat e bashkëshortes. Me sa i kujtohet subjekti e ka deklaruar në seksionin e pasurive; gjendjen cash prej 10.000 euro, në sistemin online. Ky deklaram i gjendjes cash, ka mundësi të mos jetë ruajtur në të dhënat e sistemit online”*. Saktësoi se ishte lapsus.

Konkluzion:

Llogaria në shumën 10.000 Euro ishte krijuar në vitin 2023, me burim nga të ardhurat familjare të kursyera gjatë vitit 2022. **Konfirmohet deklarami** me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e BKT.

VI. DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

- **Paga taksë solidariteti**, në Policinë e Shtetit nga data 1.10.1991 – 15.05.2005, afërsisht 4.115.490 lekë.
- **Paga, shpërblime, honorare, veshmbathje**, në Policinë e Shtetit nga data 16.05.2015 – Prill 2018. Shuma 15.402.547 lekë.
- **Paga, shpërblime, honorare, veshmbathje, në Policinë e Shtetit**, nga muaji Maj 2018 - 31.12.2022. Shuma 6.487.113 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Vërtetim nr. *** prot.**, datë 19.4.2018, nga Drejtoria Vendore e Policisë Kukës, që vërteton se Arjan Muça ka përfituar të ardhura neto, për periudhën 29.02.1992 - 15.12.1992, në vlerën 34.153 lekë.
- **Vërtetim nr. *** prot.**, datë 14.11.2019, nga Drejtoria Vendore e Policisë Dibër, që vërteton se Arjan Muça ka përfituar të ardhura neto, për periudhën 08.05.1993 - 31.07.1993, në vlerën 11.008 lekë.
- **Vërtetim nr. *** prot.**, datë 13.11.2019, nga Komisariati i Policisë Tropojë, që vërteton se Arjan Muça ka përfituar të ardhura neto për periudhën 01.10.1993 - 28.02.1995, në vlerën 134.243 lekë.
- **Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare**, nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan, që vërteton se Arjan Muça ka përfituar të ardhura neto për periudhën 01.03.1995 - 15.04.1995, dhe 16.08.1999 - 30.09.1999, në vlerën 30.091 lekë.
- **Vërtetim nga Ministria e Brendshme**, ku vërtetohet se Arjan Muça ka përfituar të ardhura neto, për periudhën 16.04.1995 - 15.04.1998, në vlerën 425.368 lekë.
- **Vërtetim për bazën e vlerësueshme**, dhe pagën neto mesatare, nga Drejtoria Vendore e Policisë, Tiranë, që vërteton se Arjan Muça ka përfituar të ardhura neto për periudhën 16.04.1998 - 16.02.2002 dhe viti 2005, në vlerën 2.333.050 lekë.
- **Vërtetim për bazën e vlerësueshme**, dhe pagën neto mesatare, nga Drejtoria Vendore e Policisë Berat, që vërteton se Arjan Muça ka përfituar të ardhura neto për periudhën 25.4.2004 - 31.12.2004, në vlerën 485.069 lekë.
- **Vërtetim për bazën e vlerësueshme**, dhe pagën neto mesatare, datë 13.11.2019, nga Drejtoria Përgjithshme e Policisë së Shtetit, që vërteton se Arjan Muça ka përfituar të ardhura neto dhe orë suplementare, shpërblim, veshje, për periudhën 16.02.2002 - 25.04.2004, 25.04.2006 - 31.12.2012 dhe 25.05.2015 - 31.12.2017. Për periudhën 16.02.2022 - 25.04.2004, në vlerën 1.172.548 lekë.
- **Vërtetim për bazën e vlerësueshme**, dhe pagën neto mesatare, nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, që vërteton se Arjan Muça ka përfituar të ardhura neto për periudhën 01.01.2006 - 25.04.2006.
- **Vërtetim nr. *** prot.**, datë 15.11.2019, nga Drejtoria Përgjithshme e Policisë së Shtetit, që vërteton se Arjan Muça ka përfituar të ardhura neto, për periudhën 01.12.2012 - 31.10.2013.
- **Vërtetim nr. *** prot.**, datë 14.11.2019, nga Akademia e Sigurisë, që vërteton se Arjan Muça ka përfituar të ardhura neto, për periudhën 11.10.2013 - 05.06.2014.
- **Vërtetim nr. *** prot.**, datë 21.11.2019, nga Departamenti për Kufirin dhe Emigracionin, që vërteton se Arjan Muça ka përfituar të ardhura neto + shpërblime, për periudhën 12.01.2015 - 26.5.2015.
- **Vërtetim për bazën e vlerësueshme**, dhe pagën neto mesatare, datë 13.11.2019, nga Drejtoria Përgjithshme e Policisë së Shtetit, që vërteton se Arjan Muça ka përfituar të ardhura neto, për periudhën 01.01.2018 - 15.04.2019.
- **Vërtetim për bazën e vlerësueshme**, dhe pagën neto mesatare, datë 13.11.2019, nga ISSH, që vërteton se Arjan Muça ka përfituar të ardhura neto, për periudhën 15.04.2019 - 06.11.2020.

- **Vërtetim, nga DPPSH**, që vërteton se Arjan Muça ka përfituar të ardhura neto + shpërblime + veshje + komisione, për periudhën 01.01.2021 - 31.12.2022.
- **Vendim nr. ***, datë 19.8.2009**, nga Këshilli i Ministrave, për shpërblim të çdo punonjësi të Policisë së Forcës së Posaçme në Policinë e Shtetit, në vlerën 1.000.000 lekë. Kthim përgjigje nr. *** prot, datë 19.11.2019, nga DPPSH, konfirmon se Arjan Muça ka përfituar shpërblim në vitin 2009, në shumën 1.000.000 lekë.
- Kopje të regjistrimit për llogaritjen e rrogës, të Arjan Muça, ndër vite + përmbledhëse.

Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

- ✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. *** prot., datë 08.05.2023, përcjell nxjerrje llogarie bankare, ku konfirmohet kreditimi i pagave të Arjan Muça, për periudhën 17.5.2005-28.04.2023. Për periudhën 01.01.2006 - 06.03.2023, të ardhurat nga paga janë në shumën 18.839.960 lekë.
 - ✚ **Tirana Bank**, me shkresën nr. *** prot, datë 08.05.2023, përcjell nxjerrje llogarie bankare, ku konfirmohet kreditimi i pagave të Arjan Muça, për periudhën 06.01.2011 - dhjetor 2013, në vlerën rreth 3.652.797 lekë.
 - ✚ **ISSH**, me shkresën nr.6/30 prot., datë 10.5.2023, konfirmon se Arjan Muça ka përfituar të ardhura nga punësimi pranë subjekteve "Drejtoria e Përqasjes Juridike Ndërkombëtare, Qendra e Formimit Policor, Drejtoria për Kufirin dhe Migracionin, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Drejtoria e Policisë Qarkut Elbasan", për periudhën, dhjetor 2012-mars 2023.
- ✓ **Të ardhurat e subjektit nga paga, shpërblimet, dietat, veshje etj. për periudhën shkurt 1992 - mars 2023, konfirmohen në vlerën totale rreth 28.118.000 lekë.**

VII. DETYRIME FINANCIARE

- ✚ **Huamarrje për blerje apartamenti banimi**, viti 2011, person fizik. Shuma e huamarrjes 50.000 euro.
 - ✚ **Huamarrja² është shlyer me këste**. Deri në dhjetor të vitit 2021 është shlyer e gjithë shuma. Detyrimi i mbetur 0 euro.
- ✓ **Trajtuar më lartë mënyra e marrjes dhe shlyerjes së kësaj huaje.**

VIII. SHPENZIMET E DEKLARUESHME

Të vitit të fundit kalendarik për qira banese, ujë, drita, telefon dhe internet, si dhe të gjitha ato pagesa periodike për kontratat e furnizimit apo pajtimit në emër të subjektit ose personave të lidhur.

² Deklaratë noteriale nr. 3717, datë 25.11.2019. Deklaratë noteriale nr.7, datë 4.1.2022.

Periudha 01.01.2022 - 31.12.2022

- Shpenzimet për ujë, (janar - dhjetor 2022), **48.148 lekë**.
- Shpenzimet për energji elektrike (janar - dhjetor 2022), **101.713 lekë**.
- Shpenzimet për telefoninë fikse (janar - dhjetor 2022), **14.427 lekë**.

✓ **Shuma, total: 164.588 lekë.**

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Librezë nga Ujësjetllës Kanalizime Sh. A. Tiranë**, në emër të Arjan Muça, në adresën Rr. "***", shk. 1, ap. 28, me nr. kontrate ***.
- ✓ Pagesat për vitin 2022, janë në vlerën **33.586 lekë**.
- **Librezë nga Ujësjetllës Kanalizime Sh. A. Tiranë**, në emër të Laurela Muça, në adresën Rr. "Z. Baboçi", shkalla 2, me nr. kontrate 111136.
- ✓ Pagesat për vitin 2022, janë në vlerën **14.571 lekë**.
- **Librezë OSSHE në emër të Arjan Muça**, me adresë Elbasan, TR-2, me nr. kontrate ***.
- ✓ Pagesat për vitin 2022, janë në vlerën **84.411 lekë**.
- **Librezë FSHU, në emër të Arjan Muça**, me adresë Qendra Burrel, TR-2, me nr. kontrate ***.
- ✓ Pagesat për energji elektrike, për vitin 2022, janë në vlerën **8.758 lekë**.
- **Libreze FSHU në emër të Laurela Muça**, me adresë Rr. "Z. Baboçi", TR-2, me nr. kontrate ***.
- ✓ Pagesat për energji elektrike, për vitin 2022, janë në vlerën **6.806 lekë**.
- **Librezë telefoni fiks**, me nr. ***** në emër të Arjan Muça.
- ✓ Pagesat për vitin 2022, janë në vlerën **14.727 lekë**.
- ✚ **FSHU, me shkresën nr. *** prot, datë 24.5.2023**, konfirmon se në emër të Arjan Muça, për periudhën deri në datë 06.03.2023, referuar të dhënave të sistemi të faturimit, identifikohet si abonent me kontratë furnizimi me energji elektrike nr. ***** në instancën Burrel. Kopje e sistemit dhe detajet e pagesave për periudhën 26.01.2022 - 21.12.2022, të cilat janë në vlerën rreth ***.
- ✚ **Shoqëria Rajonale Ujësjetllës - Kanalizime Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 05.06.2023**, konfirmon se në emër të Arjan Muça, rezulton kontratë nr. *** , me adresë rruga *** me status aktiv, në kategorinë konsumatorë familjare, me detyrime të likuiduara deri në prill 2023. Kopje e sistemit të pagesave për periudhën janar 2022 - dhjetor 2022, në vlerën **33.595 lekë**.

- ✚ Në emër të Arjan Muça, rezulton kontratë nr. ***, për objektin me adresë: rruga " ***" me status aktiv, në kategorinë konsumatorë familjare, me detyrime të likuiduara deri në mars 2023.
- ✓ Nga kontrolli në arkivën e UKT sh.a., nuk disponojnë asnjë dokument që vërteton se shtetasi Arjan Muça ka të njëjtat gjeneralitete me personin e kërkuar në shkresën tonë.
- ✚ Shoqëria Rajonale Ujësjiellës - Kanalizime Durrës, me shkresën nr. *** prot., datë 29.05.2023, konfirmon se në emër të Arjan Muça, figuron një kontratë nr.***, me adresë; Firma J. ***, për të cilin nuk disponohen të dhëna për gjeneralitetet për të saktësuar nëse bëhet fjalë për të njëjtin shtetas të kërkuar. Nuk disponohet as kopje e kontratës.
- ✚ Shoqëria Rajonale Ujësjiellës - Kanalizime Fier, me shkresën nr. *** prot., datë 05.05.2023, konfirmon se në emër të Arjan Muça ka kontratë nr. ***, Zona Mallakastër, (nuk disponohet kartë ID në sistem). Kontrata nr. *** Zona Cakran (nuk disponohet kartë Id - në sistem).
- Kopje të sistemit për abonentin Arjan Muça, në Mallakastër, me nr. kontrate *** dhe informacion nga sistemi për pagesat, për periudhën 01.11.2017 - prill 2023. Kopje të sistemit për abonentin Arjan Muça në Mallakastër, me nr. kontrate *** dhe informacion nga sistemi për pagesat, për periudhën nëntor 2016 - mars 2023.
- ✚ Shoqëria Rajonale Ujësjiellës - Kanalizime Sarandë, me shkresën nr. *** prot., datë 11.05.2023, konfirmon se Arjan Muça është abonent me kontratë nr. *** dhe ndodhet në Lagjen nr.9, Rr. "9 Tetori" Delvinë. Bashkëlidhur: Raport i detajuar për faturat e klientit, për periudhën janar 2022 - dhjetor 2022. Faturë furnizimi mars 2023.
- ✚ 10 Shoqëri Rajonale të Ujësjiellës - Kanalizime, me shkresat nr. ** - ** prot, nuk konfirmojnë kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

Konkluzion:

- ✓ **Trupa e vlerësimit konstaton** se për faktet e sipërpërmendura në lidhje me numrin e abonentëve me gjeneralitetet Arjan Muça **nuk provohet fakti se këta abonentë janë me gjeneralitetet e plota** si subjekti i vlerësimit Arjan Selim Muça pasi nuk provohet as atësia dhe as numëri i identifikimit.
- ✚ **One Albania sh. a, me shkresën nr. 6/49 prot, datë 31.5.2023**, konfirmon se në emër të Arjan Selim Muça, rezultojnë të regjistruara numrat fiks One Albania nr. 355***; 355***. Totali i shpenzimeve për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022, është në shumën 19.289 lekë. Bashkëlidhur kopje të dhëna për abonentin Arjan Muça, i abonuar në numrat mobile 355***, 355***, 355***, 355***, ku shpenzimet në total për vitin 2022, janë në vlerën rreth 40.700 lekë.

- ✚ **Vodafone Albania, shkresën nr. *** prot, datë 12.06.2023**, konfirmon se në emër të Arjan Selim Muça, dhe personave të lidhur me të, nuk rezultojnë të regjistruara numra mobile, për periudhën e kërkuar.
- ✚ **Albania Satellite Communications shpk, me shkresën nr. *** prot, datë 15.05.2023**, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.
- ✚ **Abissnet sha, me shkresën nr. **/prot., datë11.05.2015**, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të. **Digicom sha, me shkresën nr. *** prot., datë12.05.2023**, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

Në proces-verbalin e datës 16.06.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti u pyet në lidhje me konstatimet e institucioneve.

Me postën elektronike të datës 22.06.2023, drejtuar ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti sqaroi se “...libreza OSSHE, me adresë Elbasan TR-2, nr. kontrate *** është shënuar me shkrim dore "Elbasan" nga operatorja e pagesave e OSSHE në Elbasan, në kohën kur subjekti ka qenë me punë si Drejtor i Policisë së Elbasanit 2019 - 2020. Meqë libreza e vjetër mbaroi, ajo plotësoi një të re dhe e ka shënuar Elbasan, duke menduar se subjekti ishte abonent i Elbasanit, por në thelb nuk ka asnjë ndryshim”.

Në lidhje me librezën FSHU, në emër të Arjan Muça, subjekti sqaroi se me adresë qendra Burrel Tr.2 me nr. kontrate ***, është libreza e shtëpisë së fshatit Sebisht, i cili, me energji elektrike furnizohet nga Bulqiza, që varet nga Drejtoria Rajonale e Burrelit. Lidhur me librezën në emër të Laurela Muça, me adresë rr. "****" Tr.2, me kontratë ***, deklaroi se “është libreza e shtëpisë sonë në këtë adresë”.

Subjekti sqaroi se “...ka vetëm 2 kontrata të lidhura me Ujësjellës Kanalizime sh. a Tiranë dhe këto kontrata janë ato që ka deklaruar. Gjithashtu shumat e paguara që ka deklaruar, përputhen plotësisht me ato që ka konfirmuar Ujësjellës Kanalizime sh.a. Tiranë. Lidhur me librezën në emër të Laurela Muça, me adresë rr. "****" me kontratë ***, është libreza e shtëpisë në këtë adresë. Libreza është rinovuar në muajin janar 2023. Libreza e re mban të njëjtin nr. kontrate, por me fraksion I”.

Në lidhje me konstatimet nga Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Sarandë, Durrës, Fier dhe Tiranë (Komuna Parisit, Ali Demi), subjekti “deklaroi nën përgjegjësinë e tij, që nuk kanë asnjë lidhje me të apo familjarët e tij”.

Subjekti sqaroi se “ai ka deklaruar vetëm telefonin fix, por të dhënat për numrat e telefonisë mobile i ka deklaruar në Deklaratën për kontrollin e figurës. Ka qenë një harresë nga ana e tij”.

Ai konfirmoi informacionin e sjellë nga kompania One Albania, si dhe vlerën e shpenzimeve.

Paraqiti bashkëlidhur:

- Librezë **OSSHE**, në emër të Arjan Muça, me adresë Elbasan, TR-2, me nr. kontrate 188473.
 - Librezë **FSHU**, në emër të Arjan Muça, me adresë Qendra Burrel, TR-2, me nr. kontrate 102505.
 - Librezë **FSHU**, në emër të Laurela Muça, me adresë Rr. "Z. Baboçi", TR-2, me nr. kontrate 17453.
 - Librezë nga Ujësjetllës Kanalizime sh.a. Tiranë, në emër të Arjan Muça, në adresën Rr. "***", shk. nr. 1, ap. 28, me nr. kontrate ***.
 - Librezë nga Ujësjetllës Kanalizime sh.a. Tiranë, në emër të Laurela Muça, në adresën Rr. "Z. **", shk. nr.2, me nr. kontrate ***.
 - Librezë nga Ujësjetllës Kanalizime sh.a. Tiranë, në emër të Laurela Muça, në adresën Rr. "***", kontratë ***.
- ✓ **Shpenzimet e deklaruara nga subjekti dhe të verifikuara nga trupa e vlerësimit, për ujë + drita + telefoni + internet, gjatë periudhës së sipërcituar, me kontrata në emër të subjektit dhe/apo personave të lidhur me të, rezultojnë në total shuma rreth 208.000 lekë.**

IX. SHPENZIME PËR UDHËTIM

Për udhëtimet private, personale apo të personave të lidhur jashtë territorit shtetëror, gjatë 3 viteve të fundit (kalendarike). Periudha 01.01.2020 - 31.12.2022, Udhëtimet për vitet 2020 – 2022:

- 27.11.2020 - 28.11.2020, fundjavë me familjen në Prizren/Kosovë, vlera 100 euro.
- 26.12.2021 - 28.12.2021, fundjavë me familjen në Budva/Mal i Zi, vlera 300 euro.
- 06.05.2022 - 08.05.2022, fundjavë me familjen në Bari/Itali vlera 800 euro.
- 02.09.2022 - 04.09.2022, fundjavë me familjen në Strugë/ Maqedoni e Veriut, vlera 250 euro.
- 26.12.2022 - 30.12.2022, event familjar (dasmë), në Taranto, Itali, vlera 800 euro.

Në proces-verbalin e datës 16.06.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti u pyet në lidhje me udhëtimet e deklaruara dhe dokumentacion justifikues ligjor.

Me postën elektronike të datës 22.06.2023, drejtuar ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti ka sqaruar, se nuk ka fatura të shpenzimeve, pasi qëndrimet e tij jashtë vendit kanë qenë të shkurtra (1-2 netë), dhe kanë fjetur në shtëpitë që jepen me qira të ulëta dhe që nuk lëshojnë fatura. Subjekti shtoi, se në listën e hyrje - daljeve të tij, të printuar nga sistemi TIMS, janë edhe 2 udhëtime të datave 20 - 24.09.2021 dhe 13 - 16.12.2021, të cilat janë udhëtime shtetërore.

Në proces-verbalin e datës 21.09.2023, drejtuar ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti paraqiti kopje të sistemit TIMS për vete dhe familjarët e tij. Kopje e TIMS-

it, hyrje - dalje për Arjan Muça, për periudhën 2020 - 31.12.2022, ku rezultojnë udhëtimet si me poshtë:

- Dalje datë 27.11.2020, hyrje në datë 28.11.2020,
 - Dalje datë 20.9.2021, hyrje në datë 24.9.2021,
 - Dalje datë 7.10.2021, hyrje në datë 08.10.2021,
 - Dalje datë 13.12.2021, hyrje në datë 16.12.2021,
 - Dalje datë 26.12.2021, hyrje në datë 28.12.2021,
 - Dalje datë 06.05.2022, hyrje në datë 08.05.2022,
 - Dalje datë 02.09.2022, hyrje në datë 04.09.2022,
 - Dalje datë 26.12.2022, hyrje në datë 30.12.2022,
 - Hyrje datë 2.10.2022,
- ❖ **Urdhër nr. ***, datë 30.8.2021**, nga Ministria e Brendshme, për një vizitë studimore, data e nisjes 20 shtator 2021 dhe data e kthimit 24 shtator 2021, në emër të Arjan Muça, në Pire në Greqi, nëpërmjet linjës tokësore.
- ❖ **Urdhër nr. ***, datë 10.12.2021**, nga Ministria e Brendshme, për pjesëmarrje në takimin e projektit “Scope”, në Berlin Gjermani, të Arjan Muça, që do të zhvillohet nga data 14 - 15 dhjetor 2021. Data nisjes 13.12.2021, data e kthimit 16.12.2021, me linjë ajrore.
- ❖ **Urdhër nr. ***, datë 05.10.2021**, nga Ministria e Brendshme, për dërgimin me shërbim jashtë shtetit të Arjan Muça, për të marrë pjesë në Takimin Operacional, i cili zhvillohet në datë 8.10.2021, në Ohër Maqedoni. Data nisjes 07.10.2021, data e kthimit 08.10.2021, me rrugë tokësore.

Kopje e TIMS-it, hyrje - daljeve, për Laurela Muça, për periudhën 2020 - 31.12.2022 ku rezultojnë udhëtimet, si me poshtë:

- Dalje, datë 05.12.2021, hyrje në datë 08.12.2021 ***
- Dalje, datë 26.12.2021, hyrje në datë 28.12.2021 ***.
- Dalje, datë 06.05.2022, hyrje në datë 08.05.2022 ***.
- Dalje, datë 22.05.2022, hyrje në datë 26.05.2022 ***.
- Dalje, datë 02.09.2022, hyrje në datë 04.09.2022 ***.
- Dalje datë 5.12.2022, hyrje në datë 9.12.2022, ***
- Dalje datë 26.12.2022, hyrje në datë 30.12.2022, ***.
- Kërkesë për shpenzim datë 29.11.2021, nga Këshilli i Evropës, në emër të Laurela Muça, për udhëtimin në *** në datë 6.12.2021 - 7.12.2021. (Dokument në gjuhën angleze).
- Kërkesë për shpenzim datë 27.4.2022, nga Këshilli i Evropës, në emër të Laurela Muça, për udhëtimin në ***, në datë 23.5.2022 - 25.5.2022. (Dokument në gjuhën angleze).
- Kërkesë për shpenzim datë 2.11.2022, nga Këshilli i Evropës, në emër të Laurela Muça, për udhëtimin në ***, në datë 6.12.2022 - 9.12.2022. (dokument në gjuhën angleze).

Kopje e TIMS-it, hyrje - daljeve për Ohri Muça, për periudhën 2020 - 31.12.2022, ku rezultojnë udhëtimet si më poshtë:

- Dalje datë 26.12.2021, hyrje në datë 28.12.2021, ***.
- Dalje datë 6.5.2022, hyrje në datë 8.5.2022, ***.
- Dalje datë 2.9.2022, hyrje në datë 4.9.2022, ***.
- Dalje datë 5.12.2022, hyrje në datë 9.12.2022, me *** Dalje datë 26.12.2022, hyrje në datë 30.12.2022, ***.

Kopje e TIMS-it, hyrje - daljeve, për Drini Muça, për periudhën 2020 - 31.12.2022 ku rezultojnë udhëtimet si më poshtë:

- Dalje datë 26.12.2021, hyrje në datë 28.12.2021, ***.
- Dalje datë 06.05.2022, hyrje në datë 08.05.2022, ***.
- Dalje datë 02.09.2022, hyrje në datë 04.09.2022, ***.
- Dalje datë 26.12.2022, hyrje në datë 30.12.2022, ***.

Në lidhje me hyrje-daljet sipas TIMS, subjekti sqaroi se *“udhëtimi i datë 27.11.2020 - 28.11.2020, fundjavë me familjen në Prizren/ Kosovë, nuk ka qenë udhëtim me familjen, por udhëtim pune”*

Udhëtimi i datës 27 - 28.11.2020, *“është udhëtim për takim operacional me kolegët e Malit të Zi dhe kolegë të DPSSH. Udhëtimi është bërë me makinë shtetërore të Drejtorit të Policisë Kriminale, me targa AA***ZG. Nuk disponon urdhër shërbimi, për shkak se rasti dhe takimi ishte urgjent. Shpenzime për këtë udhëtim nuk ka pasur, pasi janë mbuluar nga kolegët e Malit të Zi. Udhëtimi ka qenë më pak se 24 orë”* *“Gjithashtu edhe udhëtimet³ e datave 20 - 24.09.2021, 07 - 08.10.2021 dhe 13 - 16.12.2021, janë udhëtime pune”*

Udhëtimet me familjen të datave:

26.12.2021 - 28.12.2021, fundjavë me familjen në *** vlera 300 euro.
 06.05.2022 - 08.05.2022, fundjavë me familjen në ***, vlera 800 euro.
 02.09.2022 - 04.09.2022, fundjavë me familjen në ***, vlera 250 euro.
 26.12.2022 - 30.12.2022, event familjar (dasmë), në ***, vlera 800 euro.

Në lidhje me hyrjen e datës 02.10.2022, ka dalë në datë 31.09.2022, për fundjavë me familjarë në Kosovë dhe kthyer në datën 02.10.2022. Meqenëse pika e kalimit është e përbashkët me Kosovën, në dalje nga territori shqiptar nuk bëhet regjistrimi në sistem. Shpenzimet janë rreth 250 euro, me burim të ardhurat familjare.

Bashkëshortja Laurela Muça **ka kryer 3 shërbime⁴** pune konkretisht:

- Dalje 05.12.2021 - hyrje 08.12.2021, shërbim pune në ***, shpenzimet të mbuluara nga Këshilli i Evropës.
- Dalje 22.5.2022 - hyrje 26.5.2022, shërbim pune në ***, shpenzimet të mbuluara nga Këshilli i Evropës.

³ Bashkëlidhur kopje të urdhrave

⁴ Bashkëlidhur kopje të urdhrave nga puna e bashkëshortes

- Dalje 5.12.2022 - hyrje 9.12.2022, shërbim pune në ***, shpenzimet të mbuluara nga Këshilli i Evropës.

Djali Ohri Muça, në datë 05.12.2022 - 09.12.2022, “ka udhëtuar së bashku me nënën e tij në Strasburg. Shpenzimi i biletës së djalit është në shumën 352 euro dhe është përballuar nga të ardhurat e tij. Djali ka qëndruar në hotel së bashku me nënën e tij dhe ka shpenzuar vetëm për ushqim, vlerën rreth 100 euro, me burim të ardhurat familjare. Dokument në lidhje me biletën nuk disponon”.

Subjekti dha shpjegime dhe paraqiti dokumentacionin, për sa i përket hyrje - daljeve të tij dhe personave të lidhur me të, nga RSH gjatë periudhës 2020 - 2022.

Shpenzimet e deklaruara për udhëtimet private, personale dhe të personave të lidhur, gjatë periudhës së sipërcituar, rezultojnë në **total rreth 2.800 euro**.

✚ Subjekti deklaroi shpenzimet për arsimin e fëmijëve, madhorë apo të mitur, fillimin, llojin e institucionit arsimor, emrin e institucionit, pagesat vetore, si dhe kohën e studimeve sipas periudhës së përcaktuar në nenin 32, të Ligjit nr. 12/2018.

- Shpenzimet për transport, uniformë shkollore dhe libra për djalit **Ohri Muça**⁵, në shkollën "Turgut Ozal" nga viti 2011 - 2019. **Vlera 4.078 euro**.
- Shpenzimet për transport, uniformë shkollore dhe libra për djalit **Drini Muça**⁶, në shkollën "Turgut Ozal" nga viti 2013 - 2019. **Vlera 12.122 euro**.

Shuma total: 16.200 euro.

✚ Në proces-verbalin e datës **16.6.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti u pyet për shpenzimet e shkollimit.

✚ Me postën elektronike të datës **22.6.2023** dhe proces verbalin e datës **21.9.2023**, drejtuar ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti saktësoj se “fëmijët janë arsimuar në Kolegjin Turk, duke filluar nga viti 2014, sipas dokumentacionit të paraqitur nga ana e tij. Shpenzimet e deklaruara për arsimimin e fëmijëve, gjatë periudhës 2014 - 2022, rezultojnë në total rreth 16.200 euro”.

Konkluzion:

- ✓ **Trupa e vlerësimit konstaton përputhshmëri të deklarimit të subjektit për rubrikën e shpenzimeve të formularit të deklarimit me dokumentacionin e administruar si dhe konfirmon burimin e ligjshëm të ardhurave që kanë shërbyer për realizimin e këtyre shpenzimeve.**

⁵ Vërtetim nga Turgut Ozal. nr. 2023/050 prot., datë 28.2.2023, ku vërtetohet se pagesat për nxënësin Ohri Muça, për vitet akademike 2014 - 2019, janë në shumën 4.078 euro

⁶ Vërtetim nga Turgut Ozal. nr. 2023/049 prot., datë 28.2.2023, ku vërtetohet se pagesat për nxënësin Drini Muça, për vitet akademike 2014 - 2022, janë në shumën 12.122 euro

Bashkëlidhur deklaratës:

- Dëshmi trashëgimie nr. ***, datë 22.3.2017, me kërkues A. M., për çeljen e trashëgimisë ligjore pas vdekjes së S. M. Trashëgimtarët ligjorë janë Z. M, A. M., Arjan Muça dhe E. M., të cilët trashëgojnë 1/4 pjesë të pasurisë trashëgimore.
- Prokurë e posaçme nr. *** datë 25.3.2017, ku shtetasit Z. M., A. M. dhe E. M., emërojnë si përfaqësues të tyre të posaçëm Arjan Muça, i cili lejohet të kryejë veprime në lidhje me njohjen me kompensimin e pasurive, në të cilat ata figurojnë si bashkëpronarë, konkretisht në Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, si dhe çdo institucion tjetër që lidhet me të. Gjithashtu përfaqësuesit i japin të drejtën që kompensimi të kalojë fillimisht në llogarinë e tij, më pas ta shpërndaje nëpër llogaritë bankare përkatëse, të shoqëruara veprimet me dokumentacion.
- Deklaratë noteriale nr. ***, datë 25.3.2017, me deklarues Z. M., A. M., A. M. dhe E. M., në cilësinë e trashëgimtarëve ligjorë të shtetasit S. M., ku deklarojnë se me vendimin nr. ***, datë 11.10.1993, i K.K.K.P, është njohur e drejta e pronësisë dhe e kompensimit subjektivit të shpronësuar S.M. (sot trashëgimtarëve ligjor). Gjithashtu deklarojnë se nuk kanë përfituar nga shpërndarja e tokës bujqësore ndër vite dhe nuk kanë përfituar kompensim fizik.
- Mandat depozite në BKT, datë 9.3.2017, nga Arjan Muça të shumës 1.500 lekë.
- Mandat pagese datë 08.03.2017, në Credins Bank nga Arjan Muça, në shumën 700 lekë në favor të ZVRPP Tiranë.
- Mandat depozite në BKT, datë 30.3.2017, nga Arjan Muça, të shumës 2.300 lekë, për aplikimin në AKKP.
- Faturë për arkëtim nga Arjan Muça, në vlerën 2.000 lekë, për AKK Pronave.

Hetimi i trupës së vlerësimit.

- ✚ **BKT, me shkresën nr. *** prot., datë 9.5.2023**, konfirmon se Arjan Muça, ka llogari bankare në vlerën 0 lekë, në datë 6.3.2023. Bashkëlidhur nxjerrje llogari bankare.
- ✚ **Në proces-verbalin e datës 16.6.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti u pyet në lidhje me transaksionin e deklaruar.
- ✚ **Me postën elektronike të datës 22.6.2023**, drejtuar ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti ka sqaruar “...se në vitin 2017, ATP⁷, në faqen e saj zyrtare ka publikuar listën e familjeve që përfitojnë kompensim financiar për pronat e njohura me vendim të KKKPP. Në këtë publikim ishte edhe emri i babait tim të ndjerë S. M. Meqë babai kishte ndërruar jetë, jam unë personi që merret me përgatitjen e dosjes, të cilën e kam dorëzuar në ATP. Për këtë qëllim, me kërkesë të ATP ka çelur edhe një numër llogarie në BKT, të cilin e ka deklaruar, ku do të bëhej kalimi i vlerës financiare të caktuar”.

⁷ Aplikim kompensim financiar për pronat e njohura drejtuar ATP, Nr. 250 prot, datë 30.03.2017

Konkluzion:

- ✓ Nga data e dorëzimit të dosjes dhe deri aktualisht, ATP nuk ka transferuar asnjë kompensim në llogarinë e hapur nga subjekti në BKT. Gjendja e llogarisë ka qenë dhe është 0 (zero).
- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar. Subjekti ka dhënë sqarime në lidhje me deklarinin e tij.

X. DEKLARIMI I BASHKËSHORTES LAURELA MUÇA

Pasuri nr.1:

- ❖ Apartament banimi, me sipërfaqe 61.8 m², Nj. 9, Rr. "****", Hyrja nr. **, Apartamenti **, Tiranë blerë në vitin 2003. Vlera: 30.000 Usd. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit: a) 20.000 Usd, kredi nga NBG Bank, viti 2003. b) 10.000 Usd kursime nga paga ime dhe e b/shortit deri në v.2003. **Trajtuar më lart.**

Pasuri nr.2:

- ❖ Apartament banimi, me sipërfaqe 62 m², Rr. "****", P. *** Shk.** Ap.** Tiranë.

Burimi i krijimit: Përfitur nga privatizimi. Pjesa takuese: 44 %.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Çertifikatë për vërtetim pronësie, datë 19.03.2003, në emër të P.Sh., Laurela Shytaj dhe J.Sh. e llojit apartamentit me sipërfaqe 62 m², i regjistruar në adresën Rr. "****", P.***, Shk. **, K.**, Ap.**, Tiranë, nr. pasurie ***, vol. **, fq.***, ZK ***. Kartela e pasurisë së paluajtshme ku Laurela Shytaj zotëron 4/9 pjesë të pasurisë.
- Drejtoria Vendore e ASHK, Tirana Rurale 1, Tirana Rurale 2, Tirana Jug, Tirana Veri, Zonat e Stimuluara, në përgjigjet e tyre nr. *** prot., nuk konfirmojnë pasuri të regjistruar në emër të subjektit dhe personave të lidhur me të.

Hetimi i trupës së vlerësimit

Në proces-verbalin e datës **16.06.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti u pyet në lidhje me përfitimin e pronës.

Me postën elektronike të datës **22.06.2023**, drejtuar ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti ka sqaruar “...se në kohën e privatizimit të banesës së familjarëve të bashkëshortes në vitin 1994, bashkëshortja ka qenë në moshë madhore, duke u bërë bashkëpronare së bashku me babain dhe nënën e saj. Pas vdekjes së të atit, me çeljen e trashëgimisë, pjesës fillestare i është shtuar edhe pjesa takuese sipas trashëgimisë”.

Paraqiti:

Kontratë shitblerje me palë shitëse Nd. K. Banesave dhe blerës L.Sh., P.Sh. dhe Laurela Shyti, të apartamentit sipërfaqe 62 m², që ndodhet në rr. "****", në Tiranë. Praktika e privatizimit.

Konkluzion:

- ✓ **Apartamenti me sipërfaqe 62 m², në adresën "****" Tirane, është përfituar nga privatizim i banesave shtetërore dhe bashkëshortja e subjektit ka pjesë takuese sipas ligjit dhe aktit të trashëgimisë ligjore pas vdekjes së babait.**
- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e paraqitur. ASHK nuk konfirmon regjistrimin e apartamentit në emër të bashkëshortes.**

Pasuri nr. 3:

- ❖ Llogari bankare për pagat në Intesa SanPaolo Bank, me gjendje deri në datë 31.12.2022 në shumën 200 lekë dhe 20 Euro. Pjesa takuese: 100%.

Burimi i krijimit: a) Të ardhura në lekë nga paga në Kolegjin Universitar "Beder". Të ardhura në euro, nga paga në Zyrën e Këshillit të Evropës Tiranë.

Bashkëlidhur deklaratës:

Nxjerrje llogari bankare në Intesa SanPaolo Bank, në emër të Laurela Muça në të cilën konfirmohen pagesat nga punëdhënësit në monedhën euro, për periudhën 29.01.2008 - 13.04.2011. Intesa SanPaolo Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 15.05.2023, konfirmon se Laurela Muça, ka llogari bankare në vlerën 0 lekë në datë 06.03.2023 dhe 518 euro në datën 06.03.2023. Bashkëlidhur nxjerrje llogari bankare.

Konkluzion:

- ✓ **Intesa SanPaolo Bank, konfirmon gjendjen e llogarive të Laurela Muça, në datën 06.03.2023, në vlerën 0 lekë dhe 518 euro.**

Pasuri nr. 4:

- ❖ Gjendje Cash. Vlera: 600.000 lekë. Pjesa takuese: 50%. **Trajtuar më lart.**

Pasuri nr. 5:

- ❖ Fondi i pensionit i krijuar nga Këshilli i Evropës në përputhjeje me kontratën e punës dhe bazuar në pagën mujore. Vlera: 26.818 euro. Pjesa takuese: 100%.

Bashkëlidhur deklaratës:

Nxjerrje llogari kursime (pensioni), në emër të Laurela Shytaj (Muça), me referencë nga Këshilli i Evropës, për periudhën 2012 - 2019, balanca në datën 31.12.2019, është në vlerën 26.818 euro. (dokumente në gjuhën angleze)

Hetimi i trupës së vlerësimit

ISSH, me shkresën nr.* prot., datë 10.05.2023**, konfirmon se Laurela Muça ka përfituar të ardhura nga punësimi pranë subjekteve "Diamant Plus, Fondacioni Sema, Fondacioni Hafiz Ali Korca", për periudhën gusht 2013 - korrik 2018.

Në proces-verbalin e datës 16.06.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti u pyet në lidhje me fondin e pensionit.

- **Me postën elektronike të datës 22.06.2023**, drejtuar ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti sqaroi se “...*fondi i pensionit të Këshillit të Evropës menaxhohet nga kompania ndërkombëtare AXA, e cila dërgon në mënyrë periodike informacion mbi gjendjen e llogarisë. Njoftimi i fundit është dokumenti i paraqitur me datë 31.12.2019. Fondi i pensionit bëhet aktiv vetëm me mbushjen e moshës së pensionit*”. Gjithashtu sqaroi se “...*nga 1 janar 2018, bashkëshortja është e punësuar pranë zyrës së Këshillit të Evropës Tiranë, personeli i të cilit është i lidhur me skemën e sigurimit të detyrueshëm të Këshillit të Evropës dhe një skemë të detyrueshme pensioni të krijuar nga Këshilli i Evropës për këtë qëllim, dhe nuk i nënshtrohet asnjë skeme kombëtare të sigurimit ose ndonjë skeme të ngjashme private*”.

Çertifikatë e punësimit datë 22.06.2023, nga Këshilli i Evropës që vërteton se Laurela Muça Shytaj, është anëtare e stafit, nga data 01.07.2018 deri më 31.12.2023. Më parë ajo kishte kontrata të ndryshme me Këshillin e Evropës nga data 2 maj 2007- 31.05.2018.

Çertifikatë datë 22.06.2023, nga Këshilli i Evropës, që vërteton se Laurela Muça - Shytaj, është anëtare e stafit nga data 01.07.2018 deri më 31.12.2023.

Subjekti ka paraqitur shpjegime dhe dokumentacion justifikues ligjor, në lidhje me deklarimin e fondit të pensionit. Dokumenti në lidhje me Fondin e Pensionit të bashkëshortes është i datës 31.12.2019.

Konkluzion:

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e paraqitur**

XI. DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

- Të ardhura nga paga ne Fondacionin Ndërkombëtare për sistemet Zgjedhore (IFED), nga muaji gusht 1999 deri në nëntor 2003. Vlera 27.300 Usd.

- Të ardhura nga paga si koordinatorë në Projektin, Përmirësimi i Sistemit të Integruar të planifikimit, në kuadër të Programit Cards në vitet 2005 - 2006. Vlera 13.200 euro.
- Të ardhura nga paga në BKT, si juriste në Departamentin Ligjor, nga muaji tetor 2006 - maj 2007. Vlera 360.000 lekë.
- Të ardhura nga puna në Zyrën e Këshillit të Evropës, Tiranë, nga muaji maj 2007 - qershor 2012. Vlera 60.042 euro.
- Të ardhura nga kontrata konsulence me Ministrinë e Integritit Evropian, ECAT Tirana, Këshilli i Evropës, gjatë viteve 2013 - 2015. Vlera 3.637 euro.
- Të ardhura nga mësimdhënia në Universitetin "Beder". Vlera 3.340.000 lekë.
- Të ardhura nga puna në Zyrën e Këshillit të Evropës në Tiranë, nga muaji janar 2018 - mars 2018. Vlera 3.120 euro.
- Të ardhura nga puna në Zyrën e Këshillit të Evropës në Tiranë, nga muaji prill 2018 - 31.12.2022. Vlera 95.990 euro.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Nxjerrje llogari bankare në Intesa SanPaolo Bank, në emër të Laurela Muça, në të cilën konfirmohen pagesat nga punëdhënësit në monedhën euro, për periudhën 29.01.2008-13.04.2011.
- Nxjerrje llogari bankare në ISP Bank, të Laurela Muça, kreditohen pagat nga subjektet "Ministria e Integritit, Këshilli i Evropës, ECAT" për periudhën 16.05.2013-10.03.2015.
- Vërtetim nr. *** prot., datë 4.12.2019, nga ISSH, që konfirmon se Laurela Shytaj (Muça) ka realizuar të ardhura nga paga + raport mjekësor, mbi të cilën është derdhur kontribut nga subjekti IFES Albania/ Usaid, për periudhën prill 2001 - dhjetor 2003, në vlerën totale bruto 3.236.937 lekë. (Llogaritur neto rreth 2.600.000 lekë)
- Dokument në gjuhën angleze datë 22.11.2003, nga IFES që konfirmon se Laurela Shytaj është e punësuar pranë fondacionit nga gushti 1993 deri në 30.11.2003, si përkthyes asistente dhe konsulente.
- Kontratë shërbimi në gjuhën angleze, datë 17.01.2005, midis Euro Partners Development dhe Laurela Muça Shytaj, në pozicionin e konsulentës, me kohëzgjatje nga data 17.1.2005 - dhjetor 2005. Pagesa është në vlerën 60 euro/ditë dhe jo më pak se 220 ditë. (13.200 euro)
- Çertifikatë në gjuhën angleze, me datë 19.11.2019, nga Këshilli i Evropës, që konfirmon se shtetasja Laurela Muça, është përkohësisht anëtare e stafit pranë Këshillit të Evropës Tiranë, për periudhën 02.05.2007 - 29.06.2012 dhe 01.01.2018 - 31.05.2018. Të ardhurat neto të përfituara për periudhën 2007 - 2012, janë në shumën 54.793 euro.
- Çertifikatë, në gjuhën angleze datë 14.11.2019, nga Këshilli i Evropës, që konfirmon se shtetasja Laurela Muça, është e përjashtuar nga taksat e Këshillit të Evropës për vitin 2019. Aneks 2.
- Vërtetim nr. ekstra prot., datë 02.11.2019, nga BKT, që konfirmon se Laurela Muça ka përfituar pagë neto si juriste për periudhën dhjetor 2006 - prill 2007, në vlerën 183.675 lekë.
- Vërtetim nr. 44/1 prot., datë 18.01.2018, nga Kolegji Universitar "Beder" që konfirmon se Laurela Muça ka përfituar pagë neto si asistent lektore, në vlerën 70.000 lekë, nga data 01.03.2014.

- Deklaratë pagese nga Këshilli i Evropës në emër të Laurela Muça, për periudhën prill 2018 - dhjetor 2022, në vlerën neto rreth 94.275 euro. (mungon muaj korrik 2020) (Dokumentet në gjuhën franceze/angleze).

Hetimi i trupës së vlerësimit

- ✚ **BKT, me shkresën nr. *** prot., datë 09.05.2023**, përcjell nxjerrje llogarie bankare në emër të Laurela Muça, në të cilën i kreditohet paga nga Fondacioni Sema, Universiteti Beder", për periudhën 17.01.2014 - 10.11.2016, në vlerën 1,906,200 lekë. BKI, me postën elektronike të datës 26.05.2023, përcjell nxjerrje llogarie bankare në emër të Laurela Shytaj, në të cilën i kreditohen pagat, për periudhën 20.12.2006 - 30.04.2007, në vlerën rreth 183.675 lekë.
- ✚ **Intesa SanPaolo Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 15.05.2023**, përcjell nxjerrje llogarie bankare në emër të Laurela Muça, në të cilën i kreditohet paga nga Fondacioni Sema, Universiteti Beder", Instituti Shqiptar për Inovacionin Social, Këshilli i Evropës, Henner -Gmc, për periudhën 16.12.2016 - 28.02.2023, në vlerën rreth 2.049.000 lekë.
- ✚ **Intesa SanPaolo Bank**, nxjerrje llogarie bankare në monedhën euro të Laurela Muça, në të cilën kreditohen pagat nga subjektet "Alba Flex, Këshilli i Evropës, Kuvendi, Ministria e Integritimit", për periudhën 30.05.2007 - 06.03.2023, në vlerën rreth 178.700 euro.
- ✚ **ISSH, me shkresën nr. *** prot., datë 10.05.2023**, konfirmon se Laurela Muça ka përfutuar të ardhura nga punësimi pranë subjekteve "Diamant Plus, Fondacioni Sema, Fondacioni Hafiz Ali Korça", për periudhën gusht 2013 - korrik 2018.
- ✚ **ISSH, me shkresën nr. *** prot., datë 10.05.2023**, i kërkohet Drejtorisë së Arkivit Qendror Lundër, që të dërgohet informacion pranë ILDKPKI, për periudhën para vitit 2012, për shtetasin Arjan Muça dhe familjarët e tij.
- ✚ **Drejtoria e Arkivit Qendror, me shkresën me nr. **-Prot, datë 17.05.2023**, përcjell shkresën e Degës së Arkivit të Rajonit Tiranë, e cila informon se nga mënyra e administrimit dhe përpunimit të listë pagesave për periudhën 1994 - 2012, të punonjësve të siguruar në subjektet shtetërore, juridike apo fizike, nuk mund të konfirmohet periudhë kontributesh apo paga mbi të cilën janë siguruar, në qoftë se nuk jepet emërtimi i qendrës së punës, Nipt i subjektit, fotokopje e librezës së punës.
- Vërtetim për vjetërsinë për efekt pensioni nr. *** prot., datë 12.05.2023, konfirmon se për shtetasen Laurela Muça nuk ka të dhëna.

Konkluzion:

- ✓ Të ardhurat nga paga e bashkëshortes për periudhën prill 2001 - mars 2023, të dokumentuara, janë në shumën 6.700.000 lekë + 192.000 euro, konvertuar rreth 28.753.000 lekë.

XII. DETYRIME FINANCIARE

- ❖ Huamarrje për blerje apartamenti banimi, viti 2011, person fizik. Shuma e huamarrjes ka qenë 50.000 euro, të cilën e kam shlyer me këste deri në dhjetor të vitit 2021 ishte shlyer e gjithë shuma e huazuar. Detyrimi i mbetur 0 euro. **Trajtuar më lart.**

XIII. DEKLARIMI I DJALIT - OHRI MUÇA

Nuk disponon pasuri.

XIV. DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

- Të ardhura nga bursa e ekselencës në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, sipas listës emërore të studentëve të cilët përfitojnë bursë financiare për vitin akademik 2020 - 2021. Vlera 90.000 lekë.
- Të ardhura nga bursa e ekselencës në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, sipas listës emërore të studentëve, të cilët përfitojnë bursë financiare për vitin akademik 2021. Shuma 90.000 lekë.
- Të ardhura nga paga në shoqërinë tregtare Euro sistem Albania shpk me NIPT K82212012B, për periudhën gusht - dhjetor 2022. Shuma 200.000 lekë.

Hetimi i trupës së vlerësimit

- ✚ **Kontratë individuale pune** datë 01.09.2022, midis shoqërisë tregtare Euro sistem Albania shpk dhe punëmarrësit Ohri Muça, si agjent marketing pranë kësaj shoqërie. Kjo kontratë fillon nga data 01.09.2022 me një afat kohor të papërcaktuar. **Paga mujore/ bruto është 46.233 lekë.**
- ✚ **ProCredit Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 04.05.2023**, konfirmon se Ohri Muça, ka llogari bankare në të cilën i kreditohet paga për periudhën 12.9.2022 - 10.2.2023 në shumën 274.785 lekë.
- ✚ **Credins Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 24.05.2023**, konfirmon se Ohri Muça, ka llogari bankare në të cilën i kreditohet bursa, për periudhën 01.01.2020 - 13.02.2023 në shumën 200.000 lekë.

Konkluzion:

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e paraqitur.**

Në përfundim të hetimit të kryer:

Trupa e vlerësimit, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, ka analizuar dhe verifikuar të dhënat e mbledhura nga institucionet e ndryshme dhe në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 12/2018 i ndryshuar, në vlerësimin përfundimtar, bazuar në parimin e kontradiktorialitetit u mbështet edhe në shpjegimet që dha subjekti pas dërgimit të relacionit si dhe ato në seancën dëgjimore dhe në përfundim arriti në konkluzionin se subjekti i vlerësimit:

- **Ka bërë deklaram të saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare;**
- **Nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;**
- **Nuk është kryer fshehje e pasurisë;**
- **Nuk është kryer deklaram i rremë;**
- **Subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.**

B. KONTROLLI I FIGURËS

Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të punonjësit dhe i të dhënave të institucioneve, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve, si dhe identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.”

✚ Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të figurës, mbështetet në tre element:

1. Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e figurës, sipas përcaktimeve të nenit 36, pika 1, ligjit nr.12/2018, i ndryshuar;
2. Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;
3. Verifikimin e informacioneve të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo të personave të lidhur, në zbatim të nenit 36, pika 3, germa (ë), e ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

✚ Trupa e Vlerësimit ka kryer kontrollin e figurës të subjektit të vlerësimit **z. Arjan Muça** me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, verifikimin e vërtetësisë dhe të besueshmërisë të deklarimeve si dhe të identifikohet nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në veprimtari kriminale, sipas kushteve të parashikuara në ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar.

✚ **Për kontrollin e figurës Trupa e vlerësimit administroi:**

- a. Deklaratën e “Kontrollit të Figurës”
- b. Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.
- c. Korrespondencën me institucionet dhe agjencitë ligj zbatuese në Republikën e Shqipërisë.

✚ Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së Personelit në Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore si organ ndihmës, në përputhje me nenin 42 të ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar, për vlerësimin e kontrollit të figurës ka dorëzuar nëpërmjet shkresës Nr.*** datë 20.07.2023 raportin e kontrollit të figurës⁸ ku ka konstatuar se:

- ✓ **Subjekti i vlerësimit z. Arjan Muça, me detyrë Drejtor në “Drejtorinë kundër Narkotikëve dhe Trafikeve”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.**

Në deklaratën e Kontrollit të Figurës subjekti ka deklaruar se:

- Nuk është njohur nga të tjerët me ndonjë nofkë, emër apo mbiemër tjetër nga ai që ka patur apo ka regjistruar në gjendjen civile.
- Nuk ka pasur apo ka shtetësi tjetër.
- Nuk ka qenë asnjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet shqiptar ose i huaj për kryerjen e një vepre penale.
- Nuk ka qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligj zbatuese shqiptare apo të huaja për kryerjen e një vepre penale.
- Nuk ka është caktuar ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale në fuqi ose jo.
- Nuk është lëshuar asnjëherë ndaj tij një urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale.
- Nuk është marrë asnjëherë ndaj tij masë dëbimi nga një shtet i huaj.
- Subjekti ka deklaruar që nuk ka dijeni se ndonjë nga anëtarët e familjes së tij bashkëshorti/bashkëshortja, fëmijët, bashkëjetuesi/t si dhe personat e përfshirë në certifikatën familjare) është përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar.
- Nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme në formën e takimit, komunikimit elektronik, ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës së subjektit.
- Nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar
- Subjekti nuk është në dijeni që një nga anëtarët e familjes së tij të kenë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk ka dijeni se një person i familjes, ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s gjatë 10 viteve të fundit.
- Nuk ka patur procedime penale dhe administrative, brenda dhe jashtë vendit, sipas neneve të ligjit për garantimin dhe integritetin e personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.

⁸ Raport për kontrollin e figurës

- Nuk ka fshehur apo keq prezantuar, falsifikuar një informacion të një rëndësie të madhe, të një natyre sigurie të veçantë apo të ketë gënjyer gjatë plotësimit të formularit të deklaratës së kontrollit të figurës.
- Nuk ka kryer shkelje sigurie, apo të ketë nëpërkëmbur në mënyrë të përsëritur rregullat e sigurisë së informacionit të klasifikuar, apo të ketë tentuar të kryej aktivitet të paautorizuar në sistemet e komunikimit të informacionit të klasifikuar.
- Nuk ka kërkuar azil politik në ndonjë shtet.
- Nuk është përdorues i lëndëve narkotike.
- Nuk ka pasur asnjëherë varësi ndaj alkoolit apo lojërave të fatit
- Nuk ka vuajtur nga çrregullime mendore kronike
- Nuk ka qenë asnjëherë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Ish- Sigurimi i Shtetit para vitit 1990, sipas ligjit nr. 45/2015 “Mbi të drejtën e informimit me dokumentet e ish – shërbimit të sigurimit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.
- Nuk ka pasur emër apo mbiemër tjetër më parë.

Në bazë të informacionit të dërguar nga institucionet përgjegjëse, Trupa e vlerësimit konstatoi se:

Në mbështetje të neneve 35-42, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar trupa e vlerësimit zhvilloj hetimin mbi kontrollin e figurës duke u bazuar në kthim-përgjigjet e institucioneve ligj zbatuese në Republikën e Shqipërisë, raportin e Drejtorisë së Analizës dhe Sigurisë së Personelit dhe deklaratimet e subjektit të vlerësimit **nga ku u konstatua:**

1. **Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile** me shkresën “E paklasifikuar”, nr. **** prot., datë 12.07.2023, për subjektin e vlerësimit z. Arjan Muça bën me dije se:
 - a. Nuk ka ndryshim të gjeneralitetëve
 - b. Nuk ka ndryshuar shtetësi (lenie ose marrje shtetësie)
2. **Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve** me shkresën “i kufizuar”, nr. **** prot., datë 19.05.2023, për subjektin e vlerësimit z. Arjan Muça bën me dije se:
 - a. Nuk rezulton i dënuar
3. **Institucion Ligjzbatues** me shkresën “Sekret”, nr. **** prot., datë 25.05.2023, për subjektin e vlerësimit z. Arjan Muça bën me dije se:
 - a. Nuk disponon të dhëna.
4. **Institucion Ligjzbatues** me shkresën “I kufizuar”, nr. ****prot., datë 30.05.2023, dhe shkresë “e paklasifikuar”, nr. **** datë 30.05.2023, për subjektin e vlerësimit z. Arjan Muça si dhe për personat e lidhur sipas certifikatës familjare nuk kanë:
 - a. Të dhëna apo indice për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimin e ngritur në kuptimin penal dhe të cenimit të figurës së subjektit, të përfshirë drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta;
 - b. Të dhëna për kontakt të papërshtatshëm me persona të përfshirë në krimin e organizuar (sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr.95/2016, “për organizimin dhe funksionimin e

- institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”) ku mund të përfshihen biseda, foto, vëzhgime takimesh apo biseda telefonike etj.;*
- c. Të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona (*të dënuar ose proceduar penalisht, brenda apo jashtë territorit të republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009, “për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë i ndryshuar.*);
 - d. Të dhëna në lidhje me hetimin ose gjykimin nga një autoritet shqiptar ose i huaj për kryerjen e ndonjë vepre penale;
 - e. Të dhëna në lidhje nëse ka qenë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligj zbatuese shqiptare apo të huaja, për kryerjen e ndonjë vepre penale.
 - f. Të dhëna në lidhje me lëshimin e ndonjë urdhër-arresti ndërkombëtar, për kryerjen e një vepre penale;
 - g. Të dhëna në lidhje me ndonjë masë dëbimi nga një shtet i huaj;
 - h. Të dhëna për gjatë 10 viteve i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO.
 - i. Të dhëna që nga subjekti është kërkuar azil politik në ndonjë shtet.
 - j. Nuk ka procedime disiplinore apo masa disiplinore
5. **Institucion Ligjzbatues**, me shkresën “Konfidencial”, nr. **** prot., datë 31.05.2023., për subjektin e vlerësimit z. Arjan Muça bën me dije se:
- b. Nuk disponon të dhëna.
6. **Institucion Ligjzbatues**, me shkresë “sekret”, e datës 13.06.2023, shkresën “sekret”, nr. **** prot., datë 13.06.2023, dhe shkresën “sekret”, nr. ****. prot, datë 19.06.2023, për subjektin e vlerësimit z. Arjan Muça dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare bën me dije se:
- a. Nuk ka të dhëna për përfshirje në aktivitet të paligjshëm;
 - b. Nuk ka procedime penale të referuara;
 - c. Për subjektin e vlerësimit nuk administrohen ankesa, të dhëna ose informacione;
7. **Institucion Ligjzbatues**, me shkresën “i kufizuar”, nr. ****. prot, datë 10.07.2023 për subjektin e vlerësimit z. Arjan Muça bën me dije se:
- a. Nuk është nxjerrë urdhër ndalimi;
 - b. Nuk është kërkuar masë e sigurimit personal;
 - c. Nuk është marrë në cilësinë e të pandehurit apo presonit nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 dhe 35 të Kodit të Procedurës Penale;
 - d. Nuk ka pasur regjistrim të njoftimit të veprës penale;
 - e. Nuk ka pasur raste të urdhrit ndërkombëtar të ndalimit;
8. **Institucion Ligjzbatues**, me shkresën “i kufizuar”, nr. **** prot., 07.06.2023, bën me dije se, për subjektin e vlerësimit z. Arjan Muça :
- a. Nuk rezulton të jetë regjistruar procedimi penal.

9. **Institucion Ligjbatues**, me shkresën “sekret”, nr. **** prot., datë 25.05.2023, bën me dije se për subjektin e vlerësimit Arjan Muça dhe personat e lidhur me të:

- Rezultuan raportime, për të cilat pas verifikimeve të kryera janë të dhëna rutinore të raportuara nga bankat në kuadër të informim.

10. **Autoriteti Kombëtar për Sigurimin e Informacionit të Klasifikuar**, me shkresën ‘i kufizuar’, nr. ****prot., datë 25.05.2023 për subjektin e vlerësimit z. Arjan Muça bën me dije se:

- a. Është i pajisur me Certifikatë Sigurie Personeli (CSP), niveli i klasifikimit “Tepër Sekret” lëshuar me datë 29.09.2021, të vlefshme deri në datën 28.09.2026.
- b. Për subjektin e vlerësimit nuk është marrë vendim për refuzim, heqje apo pezullim të përkohshëm të CSP-së.
- c. Nuk disponon rekorde për shkelje sigurie në lidhje me informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror” të NATO, BE, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

11. **Avokati i Popullit** me shkresën “e paklasifikuar”, me nr. **** prot., datë 30.05.2023, për subjektin e vlerësimit z. Arjan Muça bën me dije se:

- a. Nuk ka njoftime apo ankesa nga publiku në lidhje me veprime apo mosveprime në kundërshtim me ligjin gjatë kryerjes së detyrës.
- b. Nuk ka nisje të hetimit administrativ për shkelje të kryera nga subjekti.

12. **Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit**, me shkresën “i kufizuar”, nr. *** prot., datë 08.06.2023, për subjektin e vlerësimit z. Arjan Muça, bën me dije se:

- a. Nuk ka qenë në ndjekje për spiunazh, terrorizëm si dhe anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit deri në 2 Korrik 1991.

Denoncime nga publiku

Për subjektin e vlerësimit z. Arjan Muça nuk është disponuar asnjë ankesë nëpërmjet portalit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore për denoncime nga publiku për subjektet e vlerësimit kalimtar dhe periodik.

Testi për përdorim lëndësh narkotike:

Subjekti i vlerësimit në zbatim të pikës 2, të nenit 38 të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, ka kryer testin mbi përdorimin ose jo të lëndëve narkotike. Në bazë të rezultateve të përfituara testimi për përdorim lëndësh narkotike, me nr. ***, datë 11.01.2024, “Akt Ekzaminimi Toksikologjiko-Ligjor” konkludohet se subjekti vlerësimit **z. Arjan Muça** :

- ✓ **Nuk janë zbuluar prania e substancave narkotike.**


Në përfundim të hetimit të kryer:

Trupa e vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pas një hetimi të thelluar të kontrollit të figurës për subjektin e vlerësimit Arjan Muça, nëpërmjet analizimit dhe verifikimit të dhënave të deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, analizimit dhe verifikimit të dhënave të mbledhura nga institucionet dhe agjencitë ligj zbatuese, vlerësimit të testit për përdorim lëndësh narkotike, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” i ndryshuar, arriti në konkluzionin se:

Subjekti i vlerësimit z. Arjan Muça :

- *Ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi;*
- *Nuk ka informacion në deklarimin e tij ose nga institucionet përgjegjëse të përcaktuara në këtë ligj që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.*


C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONAL

 Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimit, respektimi i rregullave të etikës dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti, në përputhje me nenet 43, 44, 45, 47, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të “Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore”.

 Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në dy elemente:

- të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar;
- raportin e përgatitur nga struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore/standardet profesionale në Policinë e Shtetit/Gardën e Republikës/Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 2, ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

Subjekti i vlerësimit z. **Arjan Muça** në momentin e dorëzimit të dokumentacionit në zbatim të ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, ka ushtruar funksionin **Drejtor në “Drejtorinë kundër Narkotikëve dhe Trafikeve”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit**. Në momentin e hedhjes së shortit dhe përzgjedhjes së trupës së vlerësimit datë 05.04.2023 subjekti i vlerësimit mbante po funksionin e Drejtor në “Drejtorinë kundër Narkotikëve dhe Trafikeve” në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

 Periudha e vlerësimit në zbatim të nenit 44 pika 2 të ligjit nr.12/2018 i ndryshuar është periudha 5-vjeçare (2018-2022). Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale do të shkrihet brenda këtij harku kohor.

C/1 RAPORTI I VLERËSIMIT PROFESIONAL POLICIA E SHETIT.

Struktura e Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit si organ ndihmës për vlerësimin e aftësive profesionale bazuar në ligjin nr.12/2018 i ndryshuar ka dorëzuar nëpërmjet shkresës nr. *** datë 30.06.2023 raportin e vlerësimit profesional është shprehur me konkluzion përfundimtar si më poshtë vijon:

✚ **Punonjësi i Policisë z. Arjan Muça është i përshtatshëm për pozicionin e tij të punës, ka arsimin dhe trajnimet përkatëse për funksionin që mban, ka përmbushur detyrat profesionale, respektuar rregullat e etikës, si dhe ka shfaqur performancë të lartë në kryerjen e detyrave funksionale.**

C/2 HETIMI I TRUPËS SË VLERËSIMIT PRANË AGJENCISË SE MBIKËQYRJES POLICORE:

- Trupa e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në përputhje me ligjin e vlerësimit si dhe ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” i ndryshuar, ka zhvilluar një hetim administrativ të plotë dhe të bazuar në fakte dhe prova duke u bazuar në:
 - Të dhënat e administruara në dosjen personale të subjektit nr. *** ;
 - Të dhënat e administruara në sistemin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore Sistemi RMIS me nr. ***;
 - Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale sipas përcaktimeve të nenit 44 pika 1 të ligjit nr.12/2018 i ndryshuar.
 - Të dhënat e siguruara nga Drejtoria e Standardeve Profesionale mbi performancën e subjektit.
- Punonjësi i Policisë, Drejtues i Parë, Arjan Selim Muça është emëruar në detyrë Drejtor në Drejtorinë kundër Narkotikëve dhe Trafikeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit me urdhrin nr.*** datë 03.11.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.
- Në zbatim të ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar, funksioni që mban z. Arjan Muça bën atë subjekt të ligjit sipas nenit 6.

Vlerësimi i nivelit të arsimit.

Niveli i arsimit	Institucioni ku janë ndjekur studimet	Fillimi	Përfundimi	Vendi	Titulli/Diploma
Arsim i Lartë	Universitet “Fakulteti Histori – Filologji”	1986	1991	Tiranë	Diplome (Mësues shkollës së mesme)
Arsim i Lartë	Akademia e Policisë	1994	2002	Tiranë	Diplomë

- Trupa e vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore administroj nga dosja e subjektit të vlerësimit diplomat.
- Në kuptim të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” të ndryshuar, pas verifikimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të administruar punonjësi/subjekti përmbush kriterin e nivelit arsimor për funksionin që mban pranë Policisë së Shtetit, në momentin e dorëzimit të deklaratës së vlerësimit të aftësive profesionale.

Konkluzion:

- ✓ **Trupa e Vlerësimit në përputhje me ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar, konstaton se subjekti i vlerësimit gëzon nivelin e nevojshëm të arsimit për pozicionin e punës që mban.**
- ✓ **Në kuptim të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, pas verifikimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të administruar punonjësi/subjekti përmbush kriterin e nivelit arsimor për funksionin që mban pranë Policisë së Shtetit.**

✚ Hetimi i zhvilluar nga Trupa e Vlerësimit mbi trajnimet dhe kualifikimet e subjektit të vlerësimit në përputhje me nenin 43-45, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

Certifikatat e trajnimeve, kualifikimet dhe medaljet:

✚ Trupa e vlerësimit pas administrimit të dosjes së personelit, raportit të vlerësimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit si dhe dokumentacionin bashkëlidhur, konstatoj se gjatë periudhës 5 vjeçare të vlerësimit në zbatim të ligjit nr.12/2018 i ndryshuar subjekti i vlerësimit:

1. nuk ka realizuar trajnime,
2. **ka marrë certifikatë për “Shërbime të Dalluara”, “Për merita të veçanta, profesionalizmin dhe përkushtimin e treguar në përmbushjen cilësore të detyrave dhe kontributin e dhënë gjatë viteve të punës në shërbim të Policisë së Shtetit”.**

Trupa e vlerësimit vë në dukje faktin se, dokumentacioni bashkëlidhur raportit të vlerësimit, përmban certifikata trajnimesh për subjektin e vlerësimit të një periudhë relativisht të hershme për harkun kohor të viteve 2001-2003. Në përputhje me dispozitat e ligjit të vlerësimit kjo periudhë nuk është objekt vlerësimi dhe për këtë arsye këto kualifikime nuk do të trajtohen në kuadrin e kualifikimeve të përfituara nga subjekti i vlerësimit për periudhën (2018-2023)

Konkluzion:

- ✓ **Trupa e vlerësimit konstaton se gjatë periudhës së vlerësimit subjekti nuk gëzon kualifikime dhe trajnime, por ka marrë certifikatë për “Shërbime të Dalluara”, “Për merita të veçanta, profesionalizmin dhe përkushtimin e treguar në përmbushjen cilësore të detyrave dhe kontributin e dhënë gjatë viteve të punës në shërbim të Policisë së Shtetit”.**

Vlerësimet e punës:

Gjatë zhvillimit të hetimit mbi procesin e vlerësimit të aftësive profesionale trupa e vlerësimit ka konstatuar se:

- Për periudhën e vlerësimit (2018-2022) në dosjen e subjekti të vlerësimit dhe në raportin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, subjekti ka vetëm dy vlerësime pune atë të vitit 2018 dhe vitit 2023 me rezultat “**shumë mirë**”

Konkluzion:

- **Trupa e vlerësimit konstaton se për vitet 2019, 2020 dhe 2021, eprorët e subjektit nuk kanë plotësuar vlerësime pune, sipas raportimeve të vetë institucionit.**

Masat disiplinore

Trupa e vlerësimit në zhvillim të hetimit ka kryer verifikime në dosjen personale të subjektit të vlerësimit si dhe në sistemin RMIS, nga ku rezulton se gjatë periudhës 5-vjeçare, (2018-2022) të përcaktuar në pikën 2 të nenit 44 të ligjit 2018 i ndryshuar, subjekti i vlerësimit nuk ka marrë asnjë masë disiplinore.

- ✓ **Trupa e Vlerësimit konstaton se subjekti përgjatë periudhës së vlerësimit nuk ka asnjë masë disiplinore në ngarkim.**

Ecuria në karrierë

Nga verifikimi i të dhënave të deklarimit të subjektit të vlerësimit, raportit të vlerësimit profesional nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, subjekti i vlerësimit Arjan Muça ka një karrierë në Policinë e Shtetit prej 31 vitesh e 2 muaj. Nga verifikimi në dosje personale rezulton se gjatë periudhës 5-vjeçare objekt deklarimi, subjekti mban:

Emërtimi i gradës	Arsyeja e ndryshimit	Nr. urdhri	Data	
			Nga	Deri
Drejtues	Ulur në gradë si masë disiplinore	Nr.1570, datë 16.05.2014	21.04.2014	22.12.2019
Drejtues i Parë	Përfunduar afati i masës disiplinore ngritur në gradë	Nr.1868, datë 20.12.2019	23.12.2019	

- ✓ Në zbatim të nenit 44 pika 2, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, referuar “ulur në gradën policore” nga “Drejtues i Parë” në “Drejtues”, si masë disiplinore, me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr. ***, datë 16.05.2014, Trupa e vlerësimit konstaton se koha e kësaj mase disiplinore është e viti 2014, jashtë periudhës 5-vjeçare objekt vlerësimi.

Data e fillimit	Data e përfundimit	Institucioni	Funksioni
06.11.2020	Aktualisht	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit	Drejtor Drejtor në “Drejtorinë kundër Narkotikëve dhe Trafikeve”
15.04.2019	05.11.2020	Drejtoria Vendore Policisë Elbasan	Drejtor i Policisë Vendore
01.05.2016	14.04.2019	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit	Specialist në Sektorin e Planifikimit Strategjik dhe Studimeve

Policia e Shtetit konkludon se:

- ✚ Nga të dhënat e faktit konstatohet se subjekti i vlerësimit gjatë periudhës së vlerësimit ka mbajtur funksionin “**Drejtor**”, në përputhje me kriteret ligjore dhe gradën që disponon. Funksionet dhe gradat që ai ka përfituar gjatë karrierës, rezultojnë në përputhje dhe në zbatim me legjislacionin rregullator të kohës, ligjeve dhe akteve nënligjore.

Hetimi i kryer nga trupa Vlerësuese:

- ✓ Nga të dhënat e faktit konstatohet se subjekti i vlerësimit gjatë periudhës së vlerësimit ka mbajtur funksionin “**Drejtor**”, në përputhje me kriteret ligjore dhe gradën që disponon.
- ✓ Trupa e vlerësimit në lidhje me ecurinë në gradë dhe në karrierë të subjektit të vlerësimit z. Arjan Muça, arrin në konkluzionin se funksionet në të cilat është emëruar subjekti si dhe grada që ai ka përfituar, rezultojnë në përputhje dhe në zbatim me legjislacionin rregullator të kohës, ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.

Pjesëmarrja në konferenca shkencore, workshope, seminare botime brenda dhe jashtë vendit.

- Trupa e Vlerësimit vë në dukje faktin se dokumentacioni bashkëlidhur raportit të vlerësimit përmban certifikata të pjesëmarrjes në Workshope, të subjektit të vlerësimit që janë në periudhë kohore e cila nuk është e përfshirë në objektin e vlerësimit të aftësive profesionale dhe se subjekti i vlerësimit nuk rezulton të ketë marrë pjesë në konferenca shkencore, workshope apo seminare, gjatë periudhës 5-vjeçare të vlerësimit, në zbatim të ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.

Konkluzion:

- ✘ **Trupa e vlerësimit konstaton se subjekti i vlerësimit gjatë periudhës 5-vjeçare të vlerësimit, nuk ka marrë pjesë në konferenca/ workshope/ seminare.**

✚ **Në përfundim të hetimit të kryer:**

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi kreu një hetim të thelluar për vlerësimin e aftësive profesionale, nëpërmjet verifikimit të dosjes personale të subjektit të vlerësimit, verifikimit të nivelit arsimor të subjektit të vlerësimit, vlerësimin e përmbushjes së detyrave funksionale dhe respektimin e rregullave të etikës në ushtrimin e detyrës si punonjës në Policinë e Shtetit, arrin në konkluzionin:

Subjekti i vlerësimit z. Arjan Muça :

- ✓ **Është i përshtatshëm duke patur arsimin/trajnimin përkatës për funksionin;**
- ✓ **Ka rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar atë funksion që mban;**
- ✓ **Ka vlerësime pozitive pune.**

KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE

Trupa Vlerësuese e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e vlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet nga subjekti i vlerësimit, arrin në përfundimin se subjekti i vlerësimit z. Arjan Muça në përputhje me nenin 60 të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e kontrollit të figurës;
- Konstatohet nivel i mjaftueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale;

PËR KËTO ARSYE

Trupa e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në pikën 7, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, pasi u mblodh në dhomë këshillimi referuar nenit 59, germa “ç”, të si dhe nenit 62 germa “ç”, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.

V E N D O S I

1. Konfirmimin në detyrë e subjektit të vlerësimit, **z. Arjan Muça**.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet subjektit të vlerësimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit brenda 15 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim u shpall në Tiranë, sot datë **02.02.2024**.

KRYESUES

EDONA DUSHAJ

RELATOR

ENTON RADOVANI

ANËTAR

KLEADA MERSINLLARI